

Osmani shpreson
që partitë "të gjejnë gjuhë
të përbashkët" për
formimin e ekzekutivit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SHQIPTARËT BASHKOHEN NË TIRANË NË MBROJTJE TË ÇLIRIMTARËVE NË HAGË



Protesta e së premtes në Tiranë, në mbështetje të çlirimtarëve që janë duke u gjykuar në Hagë, ka është bërë gjithëkombëtare. Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka theksuar se

kjo protestë nuk është e asnjë partie politike, por është zëri i popullit shqiptar, zëri i veteranëve, i familjeve të dëshmorëve dhe i gjithë atyre që nuk pajtohen me padrejtësinë

që po u bëhet krerëve të UÇK-së në Hagë. Pjesëmarrjen në këtë protestë e ka konfirmuar edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ministra dhe deputetë shqiptarë

AKTUALE



FSK-ja HYRI GABIMISHT NË VERI

F. 3

MEMLI KRASNIQI: PDK-ja, PARTIA
E VETME ME RITJE TË VOTËS NGA
ZGJEDHJET E VITIT 2021

F. 6

VERIU PA EUFORI PAS
ZGJEDHJEVE: VETËM
TË KETË PAQE DHE LIRI

F. 7

EKONOMI



MË SHUMË MBETURINA
TË TRAJTUAR MË 2024
SESA MË 2023

F. 8

NË TAKIMET VJETORE TË FMN-së
DHE BB-së, GUVERNATORI ISMAILI
PARAQET ECURINË E EKONOMISË
DHE SEKTORIT FINANCIAR

F. 8

SPORT



INFANTINO: FFK-ja DHE ADEMI PO
BËJNË PUNË TË SHKËLQYESHME,
SHTETI T'I PËRKRAHË

F. 11

ÇFARË SINJALIZOI
VIZITA E SHEFES
SË BE-së NË
KOSOVË?

F. 2



PROKURORIA NIS
HETIMET LIDHUR ME
PRETENDIMET SE NË
JUNIK VOTUAN PERSONA
TË KOMUNAVE TË TJERA

F. 5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

Endrit Shaqiri
+38344685122

INFINITY
Digital Agency

Internet Website,
Marketing...

Sulmet ruse shkaktojnë ndërprerje të prodhimit të gazit në Ukrainë

POLTAVË, 16 TETOR - Forcat ruse kanë goditur një tjetër ndërtesë për prodhimin e gazit në lindje të Ukrainës mëngjesin e 16 tetorit, duke detyruar ndërprerjen e prodhimit dhe duke shtuar presionin mbi rrjetin energjetik. Që kur ka nisur pushtimin e plotë të Ukrainës më 2022,

Moska ka sulmuar infrastrukturën ukrainase çdo dimër, duke e detyruar Kievin që të aplikojë reduktime të energjisë elektrike dhe të importojë energji. “Si rezultat i sulmit, ndërtesat për prodhimin e gazit në rajonin e Potlavës janë mbyllur”, tha DTEK, shpërndarësi më i madh

privat i rrymës në Ukrainë. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se Rusia gjatë natës së mërkurë ka lëshuar mbi 300 dronë, përfshirë edhe disa që bartnin municione tërhmuese, si dhe 37 raketa. “Këtë vjeshtë, rusët çdo ditë po e shfrytëzojnë për të sulmuar infrastrukturën tonë të

energjisë”, tha ai. Operatori ukrainas i rrjetit energjetik njoftoi për ndërprerje emergjente të rrymës në tetë rajone pas sulmeve të së enjtes. Raportimet e mëhershme të medieve sugjeruan se rreth 60 për qind e prodhimit të gazit në Ukrainë është ndërprerë për



shkak të sulmeve të fundit ruse, ndërsa sulmet ndaj centraleve elektrike kanë lënë pa rrymë qindra mijëra persona në Ukrainë.

ÇFARË SINJALIZOI VIZITA E SHEFES SË BE-së NË KOSOVË?

Ursula von der Leyen e nisi dhe e përfundoi këtë javë një turne në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, por vizita e shefes së Bashkimit Evropian në Kosovë mund të ketë qenë më e shkurtra dhe u përmbyll nga ana e saj me një postim në rrjetin social X. Ç’mesazh përçoi? Çfarë nënkuptojnë kërkesat që pati ajo për Kosovën?

PRISHTINË, 16 TETOR - Nga e hëna deri në mbrëmjen e së mërkurës kryetarja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen, udhëtoi nëpër gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, rajon që synon t’i bashkohet një ditë bllokut evropian. Në pjesën më të madhe të shteteve, von der Leyen foli për rëndësinë e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) dhe për rrugën që kanë bërë ato drejt tij. Për përparim në këtë rrugë, Kosova, tha ajo, duhet të ketë institucione të forta, t’i ulë tensionet dhe t’i bëjë hapat e nevojshëm për të përfituar nga Plani i Rritjes - paketë në vlerë prej 6 miliardë eurosh, që synon përshtetimin e rrugës së shteteve të rajonit në BE. Kosovës i kanë rënë hise rreth 900 milionë euro - që do të thotë se për kokë banori është përfituesja më e madhe e këtyre mjeteve.

Rikard Jozwiak, redaktor për Evropën i Radios Evropa e Lirë (REL), beson se komentet e von der Leyenit në rrjetin social X thjesht i pasqyrojnë prioritetet e Brukselit në Ballkanin Perëndimor, dhe se aty Kosova shihet se është e vendosur fort në prapaskenë. “Nuk po ecën përpara siç kanë bërë Mali i Zi dhe Shqipëria, nuk është një prioritet gjeostrategjik dhe ekonomik siç është Serbia,

pavarësisht belave të saj”. Augustin Palokaj, gazetar që përcjell politikën e BE-së, thotë për REL-in se vlerësimi i zyrtarëve evropianë është i saktë, dhe se nuk është fshehtësi që raportet e KE-së me Kosovën nuk janë të mira dhe të rregullta. “Kosova nuk ka fare institucione me legjitimitet të plotë, që do të kishin dalë nga zgjedhjet që janë zhvilluar qysh në muajin shkurt”. Kjo situatë, sipas tij, e ka dëmtuar më pas Kosovën në procesin e sigurimit të fondeve nga Plani i Rritjes, ndonëse vendi ka qenë ndër të parët që e ka miratuar agjendën e reformave, një proces që Bosnje e Hercegovina nuk e ka finalizuar ende. Kosova ka arritur ta konstituojë Kuvendin, tetë muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare. Në mungesë të tij, vendi nuk mundi ta ratifikonte marrëveshjen që do të mundësonte lëshimin e fondeve të BE-së.

Roli i sanksioneve

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha pas takimit me shefen e BE-së se ka kërkuar heqjen e masave ndëshkuese ndaj vendit që udhëheq. Masat, që Kosova i konsideron të padrejta, u vendosën më 2023 për shkak të përshkallëzimit të situatës në veri të vendit, dhe vetëm në maj të këtij viti nisën të



largohen gradualisht. Palokaj beson se në këtë pikë do të luajë rol procesi i transformimit të pushtetit lokal në veri të Kosovës: nëse shkon në mënyrë të duhur, atëherë vendet që duan heqjen e masave do ta kenë një argument të mirë. Ai i referohet rezulttit të zgjedhjeve lokale të 12 tetorit në katër komunat veriore të banuara me shumicë serbe, të cilat i fitoi Lista Serbe. Këto komuna janë udhëhequr nga kryetarë shqiptarë, pas tërheqjes së serbëve nga institucionet e Kosovës në fund të vitit 2022. “Kosova duhet t’i ketë institucionet e veta, që brenda Kosovës të ketë stabilitet institucional, e ato institucione të kenë raporte më korrekte me bashkësinë ndërkombëtare. Kur them më korrekte, mendoj në faktin se duhet të ketë mirëbesim në mesin e tyre, nuk e fajësoj as njërin, as tjetrën palë, sepse nuk mund të pretendojë Kosova se ka raporte të mira me Shtetet e Bashkuara, me vendet e QUINT-it [SHBA-ja, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Italia dhe Franca], as me Komisionin

Evropian, kur ata thonë se s’janë raportet e mira”. Kur jemi te zgjedhjet, janë pikërisht proceset zgjedhore në Kosovë dhe në Maqedoni të Veriut arsyetimi që përmendën zyrtarët evropianë se pse von der Leyen nuk mbajti konferenca për media pas takimeve me zyrtarë shtetërorë.

Pyetësori dhe statusi i vendit kandidat

Pavarësisht se aplikimi i Kosovës më 2022 për t’iu bashkuar BE-së ka mbetur në sirtarë dhe nuk është shqyrtuar asnjëherë, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, citohet t’i ketë kërkuar shefes së BE-së që KE-ja t’ia dorëzojë Prishtinës sa më parë pyetësorin për anëtarësim, si dhe që Kosovës t’i jepet statusi i vendit kandidat. Për Jozwiakun, Brukseli është krejtësisht i vetëdijshëm se nuk do të ecë përpara me vlerësimin e kërkesës së Kosovës për anëtarësim gjatë Presidencës aktuale daneze, apo asaj të ardhshme qipriote.

Sa për rikujtim, Kosova është e vetmja në rajon që nuk e ka statusin e vendit kandidat.

Progresi i 12 muajve të fundit

Vizita e von der Leyenit në rajonin e Ballkanit është realizuar në prag të miratimit të Raporteve të Progresit të BE-së për këto vende që synojnë bllokun. Ato konsiderohen si pasqyrë reale e situatës në secilin vend. Palokaj beson se situata, prej tetorit të vitit të shkuar e deri më tash, nuk ka qenë shumë e favorshme në Kosovë, dhe se nuk ka zhvillime të mira të cilat do të mund të reflektoheshin në raport. “Me aq sa kam dëgjuar, do të tërhiqet vërejtja për vonesat që po bëhen në Kosovë në mungesë të institucioneve funksionale, dhe Kosova në këtë mënyrë ka ngecur”. Raporti përmend në detaje përparësitë dhe ngecjet në shumë sektorë. Kosovës i është përsëritur ndër vite se normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë është rruga e vetme për ecje përpara.

Orban synon marrëveshje ekonomike me ShBA-në

BUDAPEST, 16 TETOR - Kryeministri hungarez Viktor Orban tha se pret që të takohet së shpejti me presidentin amerikan Donald Trump për të diskutuar për një marrëveshje ekonomike mes dy shteteve. “Ka një datë dhe është diskutuar rreth 80

për qind e agjendës. Kur të pajtohem me amerikanët me 20 për qindësin e mbetur, do të vendosim se kur të njoftojmë për takimin dhe më pas ai do të zhvillohet”, tha Orban, një aleat i kamotshëm i Trump, në një intervistë për Mandiner.

Orban tha se Budapesti do të dëshironte që në agjendë të ishte një marrëveshje për taksat, në mënyrë që të parandalohet tatimi i dyfishtë. Po ashtu, ai tha se do të dëshironte të bisedonte me udhëheqësin amerikan për investime.

ShBA-ja e ka ndërprerë marrëveshjen për taksat me Hungarinë më 2022 dhe vendimi ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2023. Orban ka parashikuar një “epokë të artë” të raporteve ShBA-Hungari në mandatin e Trumpit, pavarësisht tarifave



të vendosura ndaj Bashkimit Evropian që dëmtuan ekonominë e Hungarisë.

OSMANI SHPRESON QË PARTITË “TË GJEJNË GJUHË TË PËRBASHKËT” PËR FORMIMIN E EKZEKUTIVIT

PRISHTINË, 16 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se është në duart e partive politike ta formojnë qeverinë e re, duke theksuar se shpreson shumë që ato të gjejnë gjuhë të përbashkët në mënyrë që vendi të ketë ekzekutiv me mandat të plotë sa më shpejt. “Unë shpresoj shumë që sa më parë të kemi qeveri me mandat të plotë kushtetues sepse, siç e dini, qeveria në detyrë ka kompetenca të kufizuara sipas Ligjit për Qeverinë. Kjo pastaj e pengon jo vetëm punën e qeverisë, por e pengon shtetin në tërësi”, tha Osmani për gazetarët, pasi mori pjesë në një ngjarje në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Osmani tha se një ekzekutiv me mandat të plotë do të mund të shtyjë përpara reforma, të miratojë një buxhet gjithëpërfshirës dhe të marrë vendime të tjera. “Por, kur do të ndodhë kjo, siç e thashë, është në duart e partive politike, të cilat shpresoj shumë se do të gjejnë gjuhë të përbashkët dhe qytetarët e Kosovës, në përputhje me vullnetin e tyre të shprehur në zgjedhje, do të kenë qeveri me mandat të plotë”, tha e para e vendit.

Osmani e ka mandatuuar kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, për formimin e Qeverisë së re të Kosovës. Ai ka afat deri më 26 tetor që të paraqesë para Kuvendit përbërjen e re qeveritare e cila duhet të miratohet me 61 vota.

Partia e Kurtit, Lëvizja



Vetëvendosje, doli e para në zgjedhjet e 9 shkurtit, por nuk mori vota të mjaftueshme që të qeverisë e vetme. Kurti ka paralajmëruar se në ditët në vijim do të zhvillojë diskutime me partitë për formimin e koalicionit qeverisës. “Nga data që është mandatuuar janë

15 ditë dhe natyrisht që afatet rrjedhin, por negociatat për koalicione bëhen vetëm ndërmjet partive, në rastin konkret mund të bëhen edhe me deputetë. Por, janë diskutime mes partive politike, në të cilat si presidente nuk do të duhej të ndërhyja.

Rrjedhimisht, unë nuk mund ta di se deri ku kanë arritur ato negociatat, potencialisht”, deklaroi Osmani. Nën kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu nga LV-ja, ka deklaruar ditë më parë se partia e saj mund të diskutojë me Lidhjen

Demokratike të Kosovës për ndonjë koalicion të mundshëm, pasi Nisma Socialdemokrate nuk ka qenë e interesuar të përfshihet në qeverisje. Ajo e ka përjashtuar ndonjë koalicion të mundshëm me Partinë Demokratike të Kosovës dhe Listën Serbe - partinë më të madhe të serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit.

Haxhiu ka përmendur, po ashtu, mundësinë që të diskutojnë me deputetët individualë për votimin e Qeverisë së re të Kosovës.

Njohësit e zhvillimeve politike i thanë “Radios Evropa e Lirë” se gara e partive politike për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale - që do të mbahet më 9 nëntor - mund t'i ndikojë negociatat për formimin e ekzekutivit të ri.

Nëse Kurti nuk arrin të sigurojë 61 votat e nevojshme deri më 26 tetor, atëherë Osmani, sipas ligjeve, është e obliguar që brenda 10 ditëve t'i ftojë në konsultim edhe një herë partitë politike, edhe të vendosë, sipas diskrecionit të saj, për mandataren e re, nëse ajo ia dëshmon se i ka numrat për ta formuar qeverinë.

Edhe mandatarja e ardhshme duhet t'i ketë 15 ditë kohë që t'ia paraqesë Kuvendit përbërjen e kabinetit qeveritar. E nëse qeveria nuk formohet as pas 40 ditësh, presidentja Osmani duhet t'i shpallë zgjedhjet e reja.

FSK-ja HYRI GABIMISHT NË VERI

PRISHTINË, 16 TETOR - Disa automjete të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) u panë më 16 tetor në rrugët e Mitrovicës së Veriut. Nga Policia e Kosovës thanë se FSK-ja qëndroi gabimisht në pjesën veriore të vendit. “E humbën rrugën, navigacioni i GPS-së i çoi gabimisht në veri”, tha për “Radion Evropa e Lirë” zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani. Sipas tij, Policia e Kosovës i ka parë pjesëtarët e FSK-së, ka biseduar me ta dhe më pas ata janë larguar nga veriu.

Në rrjetet sociale janë publikuar video ku shihen disa kamionë të FSK-së duke kaluar përgjatë një rruge në qytetin e Mitrovicë të Veriut - një nga katër komunat në veri që janë të banuara me shumicë serbe. Mediet në gjuhën serbe thanë se ngjarja ndodhi paraditen e së enjtes dhe se FSK-ja qëndroi në veri për 5 deri në 10 minuta. Prania e FSK-së në veri të vendit është e mundur vetëm

me pëlqimin paraprak të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, bazuar në zotimin e vitit 2013 nga Qeveria e Kosovës ndaj NATO-s. Ky angazhim, i dhënë përmes një letre nga ish-kryeministri Hashim Thaçi drejtuar sekretarit të atëhershëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, mbetet në fuqi edhe sot pavarësisht prej ndryshimeve në mandatin e FSK-së.

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka bërë me dije se konvoji nga Istogu që po shkonte drejt Mitrovicës e ka ngatërruar drejtimin e lëvizjes në drejtim të veriut. “Forca e Sigurisë së Kosovës njofton publikun që sot me datë 16.10.2025 në ora 10:30, gjatë lëvizjes së konvojit të FSK-së nga Istogu për në kazermën e FSK-së në Mitrovicë, pjesëtarët e FSK-së me automjete e kanë ngatërruar drejtimin e lëvizjes”, ka njoftuar FSK-ja.

Përgjigje për këto pyetje, REL-i po pret edhe nga KFOR-i.



Ndryshe, për herë të fundit, me pëlqimin e KFOR-it, FSK-ja ishte në veri më 29 korrik të këtij viti, në një operacion kur

gjeti trupin e pajetë të një operacioni që kishte kërcyer nga ura në liqenin e Ujmanit. FSK-ja është në proces të

transformimit të saj në ushtri pas ndryshimeve ligjore të miratuara. Ky proces pritet të përmbyllet më 2028.



SHQIPTARËT BASHKOHEN NË TIRANË NË MBROJTJE TË ÇLIRIMTARËVE NË HAGË

Protesta e së premtes në Tiranë, në mbështetje të çlirimtarëve që janë duke u gjykuar në Hagë, ka është bërë gjithëkombëtare. Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka theksuar se kjo protestë nuk është e asnjë partie politike, por është zëri i popullit shqiptar, zëri i veteranëve, i familjeve të dëshmorëve dhe i gjithë atyre që nuk pajtohen me padrejtësinë që po u bëhet krerëve të UÇK-së në Hagë. Pjesëmarrjen në këtë protestë e ka konfirmuar edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ministra dhe deputetë shqiptarë

kategorikisht këto pretendime, duke theksuar se ai ka denoncuar, në çdo kohë dhe vend, atë që e cilëson si farsë kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve. Më tutje, ai thotë se është e njohur për opinionin publik se sa pak ka lëvizur Lëvizja Vetëvendosje në këtë drejtim, dhe shpreh keqardhje që kjo parti i ngatërron marrëdhëniet institucionale të Kosovës me Shqipërinë në “çorbën e balotazheve komunale”.

“Lëvizja Vetëvendosje më paska kushtuar një çarçaf të gjatë, ku shkruan se përpara 10 vjetësh unë paskam qenë pro, kurse ajo paska qenë kundër Gjykatës Speciale... Ndërkohë unë e kam denoncuar farsën ndaj Hashim Thaçit e të tjerëve kurdo e kudo ka qenë rasti a nevoja, ndërsa Lëvizja dihet se sa ka lëvizur në atë drejtim. Por unë s'jam në asnjë lloj gare me Lëvizjen dhe më vjen keq që Lëvizja i ngatërron marrëdhëniet institucionale të

Kosovës me Shqipërinë në çorbën e balotazheve komunale”, thuhet në postimin e Ramës.

Ndër të tjera, shefi i qeverisë shqiptare nëpërmjet këtij reagimi ia kujtoi LV-së se Gjykata Speciale u ngrit për trafikun e organeve, “jo për të marrë peng presidentin e Republikës së Kosovës”. “Ndërsa për qëndrimet e para 10 vjetëve - kur ajo nuk njihte as himnin e Kosovës e jo më pafajësinë e Hashim Thaçit, të cilin do ta donte përjetësisht në Hagë - i kujtoj Lëvizjes se Gjykata Speciale u ngrit për trafikun e organeve, jo për ta marrë peng presidentin e Republikës së Kosovës”.

Në fund, Rama thekson se ai nuk është organizator e as folës i protestës gjithëkombëtare “Drejtësi për Çlirimtarët”, por e mbështet me gjithë zemër. “Dhe e fundit, unë as nuk jam organizator e as nuk jam folës i protestës gjithëkombëtare “Drejtësi për Çlirimtarët”, të

cilën e mbështes me gjithë zemër e do t'i bashkohesha si pjesëmarrës i thjeshtë, nëse nuk do të isha i vetëdijshëm se çdo politizim me dashje ose jo i asaj nisme, do ta dëmtonte qëllimin dhe popullaritetin e saj”, përfundon postimi i Ramës.

Lëvizja Vetëvendosje qëndron në krah të të gjithë qytetarëve që protestojnë e kërkojnë drejtësi për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Tiranë. Mirëpo, sipas LV-së, për ecjen e sinqertë përpara si shtet e si komb, duhet patjetër të reflektojmë mbi qëndrimet tona karshi kësaj gjykate në kohën kur u themelua.

LV-ja ka theksuar se para se të protestojnë, këta aktorë dhe politikanë duhet të tregojnë të paktën një minimum pendese për qëndrimet e tyre të gabuara në të kaluarën, duke theksuar se një shembull i qartë është vetë kryeministri aktual i Shqipërisë, Edi Rama. “Reflektimi nuk është gabim,

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 16 TETOR - Sot (e premte) në orën 17:00 në sheshin “Skënderbej” në Tiranë do të mbahet protestë gjithëkombëtare në mbështetje çlirimtarëve që janë duke u gjykuar në Hagë. Të enjten kjo protestë ka marrë mbështetje nga të gjitha trojet shqiptare.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në Shqipëri, njëherësh zëvendëskryeministre, Belinda

Balluku, ka njoftuar të enjten se Rruga e Kombit do të jetë pa pagesë për 24 orë duke filluar nga mëngjesi i së premtes së 17 tetorit.

Ndërkaq kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka reaguar ashpër ndaj Lëvizjes Vetëvendosje, pas një postimi të kësaj të fundit në “Facebook”, ku pretendohet se ai kishte ardhur në Kosovë me helikopter për t'i bindur palët që të votonin për themelimin e Gjykatës Speciale. Përmes një reagimi në platformën “X”, Rama mohoi

PROKURORIA NIS HETIMET LIDHUR ME PRETENDIMET SE NË JUNIK VOTUAN PERSONA TË KOMUNAVE TË TJERA

PEJË, 16 TETOR - Prokuroria Themelore në Pejë ka nisur hetimet pas pretendimeve se në komunën e Junikut në raundin e parë të zgjedhjeve lokale të mbajtura më 12 tetor votuan persona që nuk janë banorë të kësaj komune.

Nga Prokuroria thanë se po shikohet nëse ka elemente të kryerjes së ndonjë veprë penale që ndërlidhet me keqpërdorimin e detyrës zyrtare. “Pasi kemi pranuar informacionet se ka pasur persona që nuk kanë qenë të komunës së Junikut dhe kanë votuar në proces zgjedhor. Ne si prokurori, përkatësisht kryeprokurorja [Lumturije Vuçetaj] ka përpiluar shënim zyrtar dhe, njëkohësisht, e ka deleguar rastin në Departamentin e Krimeve të Rënda, për të marrë veprime të mëtejme, për t’i sqaruar të gjitha rrethanat dhe për të parë nëse ka elemente të veprës penale. Eventualisht, nëse ka elemente të veprës penale që ndërlidhen me keqpërdorim të detyrës zyrtare apo ndonjë vepër tjetër të merren veprimet ligjore konform Kodit Penal



dhe Kodit të Procedurës Penale”, tha për “Radion Evropa e Lirë” zëdhënësi i Prokurorisë në Pejë, Shkodran Nikqi.

Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Daut Haradinaj, një ditë më parë shkroi në “Facebook” se qytetarë nga qytete të tjera “në

mënyrë shumë të organizuar janë regjistruar si votues të Junikut”, duke kërkuar që të hetohet ky rast. “KQZ duhet ta publikojë listën zgjedhore të kësaj komune, pasi kjo është shumë e qartë si skemë e dominimit numerik kriminal”, shkroi Haradinaj.

Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Junik, të drejtë vote për zgjedhjet lokale të 12 tetorit kishin 4 846 persona. Nga ta, votuan 2 490 persona.

Ndërkaq, në zgjedhjet lokale të vitit 2021, kjo komunë kishte më pak votues të regjistruar,

përkatësisht 4 527. Atëbotë, në zgjedhje morën pjesë 2 276 votues.

Juniku, në bazë të rezultateve preliminare, do ta zgjedhë kryetarin në raundin e balotazhit, kur do të përballen kandidati për kryetar komune nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ruzhdi Shehu, dhe ai i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Agron Kuçi.

Pa numëruar votat me kusht, të diasporës dhe ato të personave me nevoja të veçanta, dallimi në vota mes dy kandidatëve është i vogël, përkatësisht Shehu ka 180 vota më shumë se Kuçi.

Në ditën e zgjedhjeve prokuroria nuk raportoi për ndonjë shkelje serioze. Megjithatë, pas zgjedhjeve në Mitrovicë të Jugut, Prokuroria atje njoftoi se ka autorizuar Policinë e Kosovës që të mbledhë informacione lidhur me keqpërdorimet e mundshme të votave. Edhe në këtë komunë që, sipas rezultateve aktuale do të shkojë në balotazh, gara në raundin e parë ishte e ngushtë.

Lista Serbe i drejtohet sërish Kushtetueses

PRISHTINË, 16 TETOR - Më 16 tetor Lista Serbe sërish ka dorëzuar një ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës lidhur me zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb, duke pretenduar se janë shkelur Kushtetuta, Rregullorja e Punës së Kuvendit si dhe një aktgjykim i mëparshëm i Gjykatës Kushtetuese. “Po ashtu, kemi kërkuar vendosjen e një mase të përkohshme për t’i ndaluar veprimet antikushtetuese që mund të shkaktojnë dëme të pakthyeshme”, thuhet në njoftimin e Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve të Kosovës që gëzon mbështetjen e Beogradit.

Kuvendi i ri i Kosovës u konstituua më 10 tetor, me zgjedhjen e Nenad Rashiqit nënkryetar nga radhët e komunitetit serb. Zgjedhja e tij u bë pasi të nëntë deputetët e Listës Serbe, ndonëse u hodhën nga tri herë në votim, nuk morën votat e nevojshme. Kushtetuesja kishte trajtuar ankesën e dorëzuar më herët nga Lista Serbe lidhur me çështjen e nënkryetarëve, pasi kreu i Kuvendit, Dimal Basha, e kishte shpallur të konstituuar Kuvendin pa zgjedhjen e nënkryetarit të pestë nga radhët e komunitetit serb. Më pas, Gjykata konstatoi se Kuvendi nuk ishte i konstituuar, duke kërkuar që deputetët ta zgjidhnin nënkryetarin nga

radhët e komunitetit serb, me qëllim që të hapet rruga për formimin e qeverisë.

Në vendimin e Kushtetueses u tha se propozimi për nënkryetarin nga radhët e komuniteteve joshumicë, në këtë rast të pakicës serbe, duhet të bëhet nga shumica apo numri më i madh i deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit serb.

Pasi deputetët e Listës Serbe nuk morën numrin e mjaftueshëm të votave, kryetari i Kuvendit, Dimal Basha, kërkoi që zgjedhja e nënkryetarit serb të vazhdojë përmes shortit, duke i mundësuar deputetit tjetër serb, Nenad Rashiq nga partia



Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, të zgjidhet nënkryetar.

Rashiqi ka qenë ministër në qeverinë e Albin Kurtit, ka udhëhequr dikasterin për Komunitete dhe Kthim.

Lista Serbe thotë se zgjedhja e

Rashiqit është “jolegjitime” dhe paralajmëron se zgjedhjet do ta humbasin kuptimin nëse shumica e deputetëve shqiptarë u imponon serbëve përfaqësues, duke legalizuar ashtu “dhunën e shumicës ndaj pakicës”.

por në këtë drejtim shumë nga ata që sot dalin në kundërshtim me Gjykatën Speciale, dje ishin lobuesit më të mëdhenj për themelimin e saj. Para se të protestojnë, këta aktorë dhe politikanë duhet të tregojnë të paktën një minimum pendese për qëndrimet e tyre të gabuara në të kaluarën. Një shembull i qartë është vet kryeministri aktual i Shqipërisë, Edi Rama, i cili madje kishte ardhur në Kosovë në vizitë emergjente me

helikopter për të bindur palët këtu që të votonin pro themelimit të kësaj gjykate”, është thënë në postimin e LV-së një ditë më parë në “Facebook”.

Ndaj kësaj deklarate të LV-së ka reaguar OVLUÇK-ja, duke theksuar se tregon qartë se kjo parti po përpiket të politizojë dhe ta zbehë qëllimin e protestës së madhe që do të mbahet në Tiranë më 17 tetor. “Kjo protestë nuk është e asnjë partie politike - ajo është zëri i

popullit shqiptar, zëri i veteranëve, i familjeve të dëshmorëve dhe i gjithë atyre që nuk pajtohen me padrejtësinë që po u bëhet krerëve të UÇK-së në Hagë”, është thënë sot në reagimin e OVLUÇK-së.

Kjo organizatë ka thënë se nuk lejon dhe nuk do të lejojë që lufta e shenjtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të përdoret për interesa partiake. “Ne nuk kërkojmë retorikë politike, kërkojmë drejtësi për

luftëtarët tanë dhe ndëshkim për krimet e Serbisë. Protesta e Tiranës është protestë e kombit, jo e partive”, thuhet në këtë reagim.

OVLUÇK-ja ka shprehur falënderim për kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, i cili, sipas saj, është treguar zë i qartë dhe mbështetës i kësaj kauze të drejtë. “Protesta e Tiranës është protestë e kombit, jo e partive. Aty do të jenë mijëra shqiptarë nga të gjitha trojet, për të treguar se

UÇK-ja është nderi i kombit dhe s’ka gjykatë që mund ta njoftosë atë. Në të njëjtën kohë, OVLUÇK-ja shpreh falënderim të sinqertë për kryeministrin e Shqipërisë, z. Edi Rama, i cili është treguar zë i qartë dhe mbështetës i kësaj kauze të drejtë, si dhe për institucionet shqiptare që kanë dhënë mbështetje të plotë për mbarëvajtjen dhe organizimin e protestës në Tiranë”, është thënë në reagimin e OVLUÇK-së.

Përfundon numërimi i votave në 13 komuna

PRISHTINË, 16 TETOR - Sipas informacioneve nga Qendrat Komunale të Numërimit, deri në orën 10:00 të ditës së enjte janë verifikuar rezultatet për 1 531 vendvotime nga zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe rezultatet për subjektet politike nga zgjedhjet për kuvende komunale nga 1 494 vendvotime. Nga po kaq vendvotime, 1 494, janë numëruar votat e kandidatëve nga zgjedhjet

për kuvendet komunale. Pra, deri më tani, nga 5 142 kuti votimi që u takojnë dy llojeve të zgjedhjeve, janë procesuar 3 025. Deri më tani (e enjte, ora 10:00), aktivitetet në QKN janë përmbyllur në 13 komuna: Hani i Elezit (e hënë), Junik, Mamushë, Zveçan (e martë), Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Deçan, Shtime, Klinë, Shtërpçë, Obiliq, Istog dhe Skenderaj (e

mërkurë). Në përgjithësi, në Qendrat Komunale të Numërimit zhvillohen tri aktivitete të rëndësishme: verifikimi i rezultateve nga zgjedhjet për kryetarë të komunave; verifikimi i rezultateve të subjekteve politike nga zgjedhjet për kuvende komunale; dhe numërimi i votave të kandidatëve për anëtarë të kuvendeve komunale.



MEMLI KRASNIQI: PDK-ja, PARTIA E VETME ME RRIJTJE TË VOTËS NGA ZGJEDHJET E VITIT 2021

PRISHTINË, 16 TETOR - Kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e rregullt, në të cilën është diskutuar për zhvillimet e fundit politike në vend si dhe për procesin zgjedhor të 12 tetorit. Pas mbledhjes së kryesisë, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka mbajtur konferencë për medie, ku tha se zgjedhjet lokale shpërfaqën qartë se PDK përfaqëson modelin më të mirë të qeverisjes lokale në Kosovë. Krasniqi theksoi se PDK-ja është e vetmja parti që ka rritje të votave në Kuvendet Komunale krahasuar me vitin 2021. "Të dielën Kosova foli. Dhe mesazhi i qytetarëve ishte i qartë. PDK është modeli më i mirë i qeverisjes lokale në Kosovë. Këto ishin zgjedhjet e dyta lokale me radhë në të cilat



Partia Demokratike e Kosovës ka dalë fituese, duke marrë besimin qytetar dhe numrin më të madh të asamblistëve, ndërsa kësaj radhe edhe votën popullore. Kjo është një fitore e qytetarëve, e përgjegjësisë dhe e

punës konkrete që PDK ka dëshmuar me kandidatët e saj anëmbanë Kosovës, veçanërisht në komunat ku kemi qeverisur. Të dielën kemi marrë rreth 180 mijë vota si parti dhe jemi partie e vetme me

rritje të votës nga zgjedhjet e vitit 2021. Por kemi edhe mbi 200 mijë vota për kandidatët tanë për kryetarë, që tregon për mbështetjen e madhe qytetare për kandidatët tanë gjithandej Kosovës. Siç e dini tashmë, në tri komuna, Ferizaj, Skenderaj dhe Han i Elezit, fituam pa balotazh, qartë dhe bindshëm. Ndërkaq, në gjashtë të tjera, Prizren, Mitrovicë, Vushtrri, Kaçanik, Klinë dhe Dragash, garojmë për fitore në raundin e dytë. Krasniqi tha se PDK është kthyer si forcë kryesore politike në kryeqytet pas më shumë se dy dekadave. "Kemi marrë rreth 29 mijë vota për kryetar, mbi 10 mijë më shumë se para katër vitesh, ndërsa kemi dalë forca e dytë më e madhe politike, para Vetëvendosjes, në një garë të pabarabartë kundër pushtetit lokal dhe atij qendror. Kjo është një fitore që dëshmon rritje,

organizim dhe besim. Tani do të përqendrohemi në balotazhe. Ta përfundojmë punën me dinjitet dhe me fitore. Dhe ne do ta përmbyllim me sukses këtë mision", shtoi ai. Lideri i PDK-së tha se ky rezultat dhe këto fitore janë dëshmi e qëndrueshmërisë, e besimit dhe e vlerave të kësaj partie, të trashëguara nga Thaçi dhe Veseli. "Në fund, dua ta shpreh dedikimin tim më të sinqertë për themeluesit e PDK-së, për ish-kryetarët Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, të cilët padrejtësisht ende po mbahen në Hagë. Ata janë pjesë e frymës së fitores tonë. Me këtë rast ftoj bashkëqytetarët dhe shqiptarët kudo që janë, që të marrin pjesë në protestën në mbështetje të çlirimtarëve që mbahet pasnesër në Tiranë. Faleminderit të gjithëve për besimin!", theksoi Krasniqi.

LIDERËT TAKOJNË AMBASADORIN E RI GJERMAN NË PRISHTINË, VLERËSOHET MBËSHTETJA E GJERMANISË



PRISHTINË, 16 TETOR - Zëvendëskryeministria dhe ministria në detyrë e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka pritur në takim ambasadorin e ri të Gjermanisë në Kosovë, Rainer Rudolph. Gjatë këtij takimi ministria e uroi ambasadorin për fillimin e mandatit duke theksuar angazhimin e Kosovës për thellimin e marrëdhënieve me Gjermaninë si partnere strategjike

dhe aleate kyçe të vendit tonë. Ministria Gërvalla vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme dhe të pandërprerë që Gjermania i ka dhënë Kosovës në të gjitha fazat e shtetndërtimit si dhe në rrugëtimin e vendit drejt integritimeve evropiane dhe euroatlantike. Gërvalla theksoi rëndësinë e rolit të mërgatës sonë në Gjermani, e cila shërben si një urë lidhëse shumë e fuqishme mes dy vendeve, duke kontribuar në mënyrë të

konsiderueshme në fushat ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Gjatë takimit me ambasadorin Rudolph, gjithashtu u diskutua edhe për zgjerimin e bashkëpunimit në sektorët kyçë të ekonomisë, sigurisë, energjisë dhe inovacionit. Ministria Gërvalla dhe ambasadori u pajtuan për shtimin e investimeve dhe për nxitjen e projekteve që përfshijnë



mërgatën tonë, duke vlerësuar këtë bashkëpunim si një faktor i rëndësishëm për zhvillimin dhe të ardhmen e përbashkët të Kosovës dhe Gjermanisë. Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim ambasadorin e ri gjerman Rainer Rudolph. "Ambasadorit i urova mirëseardhjen dhe i shpreha gatishmërinë të punojmë ngushtë për tema me rëndësi për vendin tonë. Duke e uruar për

detyrën e re, ambasadorin Rudolph e falënderova për kontributin e vazhdueshëm dhe të jashtëzakonshëm që e ka dhënë Gjermania për lirinë, pavarësinë dhe zhvillimin e Kosovës. Njëherësh, vlerësova rolin jetik të Gjermanisë në sigurinë e Kosovës. Kërkova mbështetjen e tij dhe të Gjermanisë në përkushtimin tonë për të qenë pjesë NATO-s dhe BE-së", ka theksuar Haradinaj.

VERIU PA EUFORI PAS ZGJEDHJEVE: “VETËM TË KETË PAQE DHE LIRI”



PRISHTINË, 16 TETOR - Lista Serbe fitoi zgjedhjet lokale në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, pas një periudhe bojkotimi të institucioneve të Kosovës. Disa banorë serbë shprehin pakënaqësi për mungesën e institucioneve serbe, duke kërkuar kthimin e tyre dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Shoqëria civile në veri nënvizon nevojën për rishikim të vendimeve të marra nga kryetarët shqiptarë dhe veprim më të përgjegjshëm të komunitetit ndërkombëtar.

Ndërsa ecën me nxitim në rrugët e Mitrovicës së Veriut, një banor rreth të 60-ave lëviz duart me mllef, kur i kërkohet nga ekipi i “Radios Evropa e Lirë” që ta komentojë rikthimin e kësaj komune nën udhëheqjen e serbëve, të cilët përbëjnë shumicën e popullsisë aty. Më pas ndalet, kthehet dhe thotë: “Ne jemi një popull i shkatërruar, na kanë shkatërruar të gjithë dhe Beogradi na ka tradhtuar. E kuptoni...”.

Ai nuk dëshiron të flasë publikisht për pakënaqësitë e tij, por kur kamera dhe mikrofoni janë të fikur, tregon se ka humbur shpresën dhe nuk beson më në ndryshime pozitive.

Në javën pas zgjedhjeve lokale të 12 tetorit në Kosovë, mes disa banorëve të tjerë të Mitrovicës së Veriut, në vend të euforisë dhe optimizmit, mbizotëron heshtja dhe dyshimi.

Gjatë katër vjetëve të ardhshëm, kjo komunë, si dhe tri të tjerat

me shumicë serbe në veri - Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku - do të udhëhiqen nga Lista Serbe, e cila rreth tre vjet më parë i braktisi institucionet e Kosovës, në shenjë pakënaqësie me vendimet e qeverisë në Prishtinë. Në dy raste, kjo parti - më e madhja e serbëve në Kosovë, me mbështetje edhe nga Beogradi - u kërkoi mbështetësve të saj t'i bojkotonin zgjedhjet, gjë që u mundësoi kryetarëve shqiptarë të merrnin pushtetin.

“Vetëm të ketë paqe”

Një nga të rrallët që pranon të flasë publikisht është një banore e Mitrovicës së Veriut, e cila thotë se e thërrasin Muna. Por, ajo nuk dëshiron ta tregojë emrin e plotë dhe mbiemrin. “Të ketë vetëm paqe, ndoshta atëherë do të jetë pak më mirë. Vetëm të ketë paqe dhe liri”, thotë ajo për “Radion Evropa e Lirë”. E për një jetë më të mirë thotë se nevojiten punë dhe “pak më shumë para”. “Kjo nuk është jetë, kjo është vetëm mbijetesë. Çfarë të bëj me 25 000 dinarë (rreth 220 euro)?”, pyetet Muna. Pensionin e merr në Serbi, pasi autoritetet e Kosovës e hoqën nga përdorimi dinarin serb, si mjet pagese, dhe mbyllën Postën e Serbisë me arsyetimin se aktiviteti i saj ishte i paligjshëm.

Kjo është vetëm një nga arsytet për të cilat pjesëtarët e komunitetit serb janë të

pakënaqur.

Institucione të tjera serbe u mbyllën, gjithashtu, ndërsa në vend të tyre u hapën ato të Kosovës.

Autoritetet lokale i morën edhe objektet në pronësi të tyre, ndërsa Agjencia e Privatizimit e Kosovës u dha me qira disa lokale biznesmenëve shqiptarë. Megjithatë, shumica e serbëve i bojkotojnë dyqanet, restorantet apo ëmbëltoret e reja, sepse ndiejnë se “u imponohen gjëra pa pëlqimin e tyre”.

“Të kthehen institucionet serbe”

Millenkoja nga Mitrovica e Veriut beson se ardhja në pushtet e Listës Serbe mund ta sjellë edhe kthimin e institucioneve serbe në veri të Kosovës. Sipas tij, kjo çështje duhet të jetë prioritet kryesor i kryetarit të ri të komunës. Beogradi zyrtar nuk i mbylli institucionet e veta në Kosovë, por vetëm i zhvendosi në qytetet kufitare brenda territorit të Serbisë.

Punonjësit, gjithashtu, vazhdojnë të paguhen. “Pres disa ndryshime, që të bëhet më mirë për popullin serb që të mbijetojë në Kosovë; nëse nuk ka ndryshime, populli serb do të largohet nga Kosova”, thotë Millenkoja.

Dragojllloja, në anën tjetër, nuk beson se pushteti i ri lokal do të sjellë përmirësime. “Kështu do të mbetet. Asnjë vendim i marrë nuk mund të ndryshohet”, thotë ai dhe

shton: “Zoti na ndihmoftë”! “Ne, me ta [shqiptarët] nuk kemi pasur kurrë probleme. Gjithçka bëjnë autoritetet”, sipas tij.

“Një mësim i mësuar, i dëmshëm për komunitetin serb”

Miodrag Milliqeviq, drejtor ekzekutiv i organizatës joqeveritare “Aktiv” nga Mitrovica e Veriut, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se pjesëmarrja e serbëve në zgjedhjet e fundit lokale, shënoi përfundimin e periudhës së bojkotimit, duke i hapur rrugë “rishikimit të vendimeve të dëmshme”. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë parashikon që një vendim ose akt tjetër i një komune, që është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet, mund të rishikohet nga një organ mbikëqyrës - në këtë rast, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale ose një institucion tjetër përgjegjës i Qeverisë së Kosovës.

Milliqeviqi thotë se dalja e serbëve nga institucionet e Kosovës dhe bojkotimi i tyre, ka qenë “një mësim i mësuar, i dëmshëm për komunitetin serb”.

Gjatë fushatës për zgjedhjet lokale, Lista Serbe pranoi gabimin e largimit nga institucionet, duke sqaruar se ai ishte marrë për të tërhequr vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar mbi “gjendjen e

vështirë” të serbëve. “Radhën e ka tani vlerësimi i gjithë dëmit që ka shkaktuar administrata lokale në largim, në veri të Kosovës. Po ashtu, prioritet do të jenë vendimet që adresojnë çështjet lokale, të rëndësishme për komunitetin serb”, thotë Milliqeviq.

Ai thekson se, deri më tani, nuk ka pasur bashkëpunim të mirë mes komunave të udhëhequra nga serbët dhe Qeverisë së kryesuar nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti. Sipas tij, është e vështirë të parashikohet një bashkëpunim i suksesshëm në të ardhmen, nëse institucionet e reja kosovare do të udhëhiqen sërish nga Lëvizja Vetëvendosje e Kurtit.

Andaj, thotë se pret veprime më të përgjegjshme të komunitetit ndërkombëtar. “Nuk presim që ata të udhëheqin politikën lokale, por nëse ekziston një qëndrim i unifikuar dhe ai qëndrim transmetohet tek autoritetet qendrore, duhet të jetë një mesazh i qartë se çfarë duhet bërë. Prioritet për komunitetin serb mbetet stabilizimi i situatës dhe realizimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe, që pritët prej kohësh”, thotë Milliqeviq.

Ky asociacion është pjesë e një marrëveshjeje të arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Ai pritët ta rregullojë pozicionin e komunitetit serb, financimin nga Serbia dhe çështjet e ngjashme.

Në takimet vjetore të FMN-së dhe BB-së, guvernatori Ismaili paraqet ecurinë e ekonomisë dhe sektorit financiar

PRISHTINË, 16 TETOR - Delegacioni i lartë i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), i kryesuar nga guvernatori Ahmet Ismaili, në kuadër të pjesëmarrjes në Takimet Vjetore 2025 të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB), zhvilloi takim me shefin e Misionit të FMN-së për Kosovën, David Amaglobeli, si dhe me Sebastian Sosa, përfaqësues Rajonal Rezident për Ballkanin Perëndimor në FMN dhe bashkëpunëtorë të tyre.

Diskutimet u fokusuan në zhvillimet më të fundit ekonomike dhe në reformat në vazhdim në sektorin financiar të Kosovës, duke përfshirë asistencën teknike që FMN-ja po ofron në fusha të ndryshme të mandatit të BQK-së. Guvernatori Ismaili dhe zëvendësguvernatori Cakaj paraqitën ecurinë e fundit të ekonomisë dhe sektorit financiar, me theks në forcimin e mbikëqyrjes bankare, zhvillimin e mekanizmave të përmbylljes,

politikën makroprudenciale, modernizimin e infrastrukturës së pagesave dhe reformat e tjera kyçe që janë në proces. Guvernatori Ismaili shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vazhdueshme të FMN-së, duke theksuar rolin thelbësor të asistencës teknike dhe ndërtimit të kapaciteteve në zbatimin me sukses të reformave strategjike të BQK-së. Nga ana e tij, Amaglobeli vlerësoi lart pjesëmarrjen e guvernatorit në panelin e organizuar nga



FMN, derisa rikonfirmoi përkushtimin e FMN-së për ta mbështetur BQK-në për përmbushjen e mandatit të saj dhe për avancimin e reformave të sektorit financiar.

AHMETI: QEVERIA PO I MBAN 800 MILIONË EURO NË BANKËN QENDRORE E S'KA QARKULLIM E AS ZHVILLIM

PRISHTINË, 16 TETOR - Në "Përballje Podcast" Shpend Ahmeti kritikoi mënyrën si qeveria në detyrë po menaxhon buxhetin e shtetit, duke theksuar se mbi 800 milionë euro qëndrojnë të palëvizshme në Bankën Qendrore të Kosovës, në vend që të qarkullojnë në ekonomi përmes investimeve publike. Ky podcast përkrahet nga kompania EXFIS. "Shteti i mban 800 milionë euro në Bankën Qendrore, ndërsa bizneset po vuajnë për likuiditet. Kjo është e kundërta e asaj që duhet të ndodhë. Paraja duhet të qarkullojë, jo të qëndrojë në llogari", ka deklaruar Ahmeti.

Sipas tij, ky "bllokim i parasë publike" po ndikon në rritjen e normave të interesit dhe po e bën të vështirë marrjen e kredive për qytetarët dhe bizneset. "Kur shteti i tërheq paratë nga tregu, bankat kanë më pak depozita dhe e kompensojnë me norma më të larta interesi. Kështu po shtrenjtohet gjithçka - nga kreditë e biznesit te kreditë konsumuese", shpjegoi ai. Ahmeti, po ashtu, foli për rritjen e normave të interesit në kredi, duke theksuar se kërkesa për huamarrje është e madhe, por mungesa e parasë në qarkullim po i shtyn bankat t'i rrisin kostot. "Normat e interesit janë



rritur ndjeshëm. Kemi kredi investive me 7 apo 7.5 për qind interes. Kjo tregon se ka kërkesë për kredi, por s'ka likuiditet. Bankat po i shtrenjtojnë, sepse nuk kanë depozita të

mjaftueshme", ka theksuar Ahmeti. Sipas tij, një nga arsyt kryesore është mungesa e qarkullimit të parasë nga shteti në sektorin privat. "Qeveria po i shpërndan ndonjëherë 100 euro

për studentë apo kategori të caktuara, por këto para shkojnë direkt në konsum, kryesisht në import. Nuk kanë efekt zhvillimor në ekonomi", ka thënë ai. Sipas tij, Kosova mund ta ruajë stabilitetin financiar, por pa vizion të qartë për zhvillim, vendi rrezikon të mbetet në vendnumëro. "Problemi nuk është vetëm ligjor apo buxhetor, por qasja. Ne po e mbajmë ekonominë në frymë artificiale. Nuk ka investime, nuk ka qarkullim, dhe kjo e bën sistemin të ngadalshëm - si një zemër që nuk pompon mjaftueshëm për trupin", ka thënë Ahmeti. (Telegrafi)

MË SHUMË MBETURINA TË TRAJTUAR MË 2024 SESA MË 2023

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 TETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Mbeturinave të Trajtuara (AMT) për vitin 2024. Sipas të dhënave të Anketës mbi Mbeturinat e Trajtuara (AMT) për vitin 2024, sasia e përgjithshme e mbeturinave të trajtuara dhe të deponuara ka arritur në 526 143 tonë që paraqet një rritje prej 1,5 %, krahasuar me vitin 2023 (që ishin 518 592 tonë).



Nga kjo sasi: Mbeturinat e deponuara që kryesisht përfshijnë mbeturinat nga ekonomitë familjare dhe aktivitetet e ngjashme kanë

arritur në 502 917 tonë, ose 95,6 % të totalit të mbeturinave të trajtuara. Mbeturinat e ricikluara kanë arritur në 22 014 tonë që përbëjnë 4,2 % të totalit të

mbeturinave të trajtuara. Mbeturinat e sterilizuara (medicinale/spitalore) kanë arritur në 1 212 tonë që përfaqësojnë 0,2% të totalit të mbeturinave të trajtuara. Sasia e mbeturinave të trajtuara sipas llojit të mbeturinave dhe llojit të trajtimit, e shprehur në përqindje për vitin 2024 ishte: Mbeturinat nga plastika (17 %); Mbeturinat nga metalet (28 %); Mbeturinat medicinale-spitalore (5,2 %); dhe Mbeturinat nga letra dhe kartoni (49,8 %). Sasia e përgjithshme e mbeturinave të deponuara në

deponitë e licencuara në vitin 2024 ishte 502 917 tonë, duke shënuar një rritje të lehtë prej 2,6 %, krahasuar me vitin 2023. Sipas rajoneve, deponia sanitare në Prishtinë (Mirash) ka pranuar sasinë më të madhe të mbeturinave (190 513 tonë) që përbën 37,9 % të totalit të mbeturinave të deponuara në vend. Rezultatet e paraqitura në këtë publikim përbëjnë një burim të rëndësishëm statistikor për vlerësimin e gjendjes aktuale në sektorin e mbeturinave në vend.

"Nestle" do t'i shkurtojë 16 000 vende pune, shefi i ri synon rritjen e shitjeve

BERN, 16 TETOR - "Nestle" ka thënë se do t'i shkurtojë 16 000 vende pune gjatë dy viteve të ardhshme, ndërsa pronari i "KitKat" dhe "Nescafe" përpiket t'i ulë kostot dhe t'i rrisë shitjet. Kompania shumëkombëshe me seli në Zvicër tha se shkurtime do të përfshijnë

12 000 punonjës të administratës dhe 4 000 në prodhim dhe zinxhirin e furnizimit, që përbën gati 6 % të fuqisë punëtore globale të "Nestle"-s, raporton "The Guardian". "Bota po ndryshon dhe 'Nestle' duhet të ndryshojë më shpejt", tha Philipp Navratil, drejtori i ri

ekzekutiv. "Kjo do ta përfshijë marrjen e vendimeve të vështira, por të domosdoshme, për ta reduktuar numrin e punonjësve gjatë dy viteve të ardhshme. Ne do ta bëjmë këtë me respekt dhe transparencë". Shkurtime u paralajmëruan

tek kompania raportoi një rënie vjetore prej 1.9 % të shitjeve, në 65.9 miliardë franga, gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Ajo tha se kjo ishte kryesisht për shkak të efekteve negative të kursit të këmbimit prej 5.4 % dhe se në bazë organike, shitjet u rritën me 3.3 %.



INTERVISTË ME MR. NETFLIX

Ted Sarandos, çdo ditë hyn në shtëpitë e 300 milionë njerëzve në mbarë botën për t'i mbajtur para një filmi apo serie. Ai di shumë për ne. Po ne, çfarë dimë për të?

Në fund të shfaqjes së Frankenstein, pas regjisorit Guillermo del Toro dhe idhullit të ri Jacob Elordi, shfaqet një zotëri me flokë paksa të thinjur. Duartroket me entuziazëm të veçantë dhe ngre të dy gishtat e madh. Quhet Ted Sarandos dhe roli i tij zyrtar është bashkëdrejtor ekzekutiv i Netflix-it. Netflix, ajo gjë që kur e hap tingëllon “Tu-Dum” dhe që, nëse s’na ka ndryshuar jetën, na ka ndryshuar goxha zakonet. Na ka bërë të pangopur me seriale, të ndjeshëm dhe të pakënaqur, të etur për konsum; herë-herë na mërzit bollëku, herë-herë ngecim lumturisht brenda një marrëdhënieje “as me ty, as pa ty”. Netflix funksionon me një algoritëm që duket sikur e di kush jemi – por ndonjëherë, për fat, gabon dhe na sugjeron diçka që s’e dinim se donim ta shihnim. Sarandos e di dhe buzëqesh. Sarandos hyri në kompani kur Netflix ishte vetëm një shërbim me qira DVD-sh me postë. Biografia: 61 vjeç, i biri i një elektrikisti dhe i një amvise, edhe katër vëllezër, pak para në shtëpi; ndonjëherë nuk paguanin faturat dhe mbeteshin pa drita. E megjithatë, meqë e ëma e donte kinemanë, familja Sarandos pati videoregjistruesin përpara kujtdo në lagje. Jetonin në Phoenix, Arizona, ku kishte shumë pak kinema dhe, përveç një salle të vogël arthouse, vinin vetëm titujt më komercialë. Një verë Ted pa “Airplane!” 38 herë: ishte i vetmi film në program.

Por në një moment, fati i tij u kryqëzua me atë të Dale Mason-it, ish-kontrollor fluturimi nga Chicago që e urrente punën e vet. Dale kishte lexuar në një revistë se bizneset më fitimprurëse të së ardhmes do të ishin dyqanet e kasetave video dhe ato të kosit. Meqë kosin nuk e pëlqente, ndërsa filmat po, u zhvendos në Arizona dhe hapi një videotekë dy hapa larg shtëpisë së Sarandosëve. I riu Ted nisi ta frekuentonte rregullisht, përfundoi duke punuar aty, pastaj duke drejtuar zinxhirin e dyqaneve – dhe, me pak fjalë, hyri në botën e qirasë së filmave.

Pra, ju jeni mbi të gjitha një pasionant i kinemasë.

«Gjithmonë. S’kam nënvlerësuar kurrë rëndësinë e filmave dhe telefilmave. Nuk bëhet fjalë vetëm për të vrarë kohën. Ti e ndërton veten. Ndonjëherë mendoj se njerëzve u duhet një histori për t’iu kujtuar kush janë».

Në historinë tuaj, kthesa e vërtetë vjen kur njihni Reed Hastings, themeluesin e Netflix-it, atëherë në hapat e parë: merite me qira dhe shiste DVD me postë.

«Atëherë s’dija asgjë për internetin. Gjëja e parë që kam bërë ndonjëherë online ishte të

blila një biletë avioni për të shkuar ta takoja Reed-in. Ishte ulur pas një tavoline të palosëshme dhe përreth kishte tavolina të tjera si ajo. Ishte zyra e improvizuar e një start-up-i të vogël, por ndjehej që atëherë një vizion i fuqishëm për të ardhmen».

Përveç mënyrës si konsumohen historitë, platformat po ndryshojnë edhe mënyrën si shkruhen?

«Po. Aspekti më i nënvlerësuar i modelit të binge watching — “abuzimit” me episodet — është pikërisht impakti te shkrimi. Seriali ynë i parë, House of Cards, i shkruar, xhiruar dhe hedhur online i gjithi përnjëherë, ndikoi mënyrën si njerëzit shohin një serial. Por edhe mënyrën si e shkruan. Në televizionin e vjetër, shumica e publikut humbte të paktën një episod. Prandaj duhej t’u rikujtoje vazhdimisht shikuesve çfarë kishte ndodhur javën e kaluar. Ne s’kemi më nevojë ta bëjmë këtë, ndaj ka më shumë kohë për të treguar dhe zhvilluar personazhet». Të qenit global do të thotë përballje me kultura të ndryshme: magjepsëse, por edhe pengesë, për shkak të censurës dhe standardeve kulturore e fetare të çdo vendi. Pashë versionin korean të Call My Agent: çifti gay i origjinalit — dy gra — ishte kthyer në çift hetero!

«Kudo që operojmë kemi ekipe lokale që marrin vendime krijuese në terren, sepse e kuptojnë kulturën dhe jetojnë në ato vende. Një nga çelësat e suksesit tonë ka qenë të marrim shumë pak vendime “ndërkombëtare” nga Kalifornia. S’po përpiqemi të eksportojmë Hollywood-in në botë. Po përpiqemi të tregojmë histori të mëdha lokale. Detyra e parë e ekipit italian është të krijojë përmbajtje italiane për publikun italian. Këtë vit, për shembull, do të kemi filmin Il falsario me Pietro Castellitto, serialin Motorvalley me Luca Argentero dhe serialin e prezantuar në Venecia, Il Mostro, me regji të Stefano Sollima-s. Të gjitha shumë të mira dhe shumë të ndryshme mes tyre. Edhe nëse këto përmbajtje nuk “udhëtojnë” gjatë, por funksionojnë vetëm në Itali, për mua është sukses. Pastaj, sigurisht, ndonjëherë ndizet lidhja globale. Dhe ndodh diçka që i tejkalon të gjitha kufijtë».

Si me Adolescence, një produkt i lindur në Mbretërinë e Bashkuar nga ngjarje të ndodhura aty, por që theu çdo kufi.

«Sigurisht. Por mendoj edhe për raste si Stranger Things, një tjetër sukses botëror që as s’u mendua kurrë në tavolinë si i tillë. Është një serial i mbështetur te një lloj nostalgjie shumë amerikane. Më në fund, Squid



Game. S’kemi zbutur asgjë: është produkt klasik korean. Në fillim mund të jetë parë si kuriozitet, por pastaj u afirmua kudo sepse trajton tema universale si pabarazia ekonomike dhe përplasja e klasave».

Ka edhe një element tjetër kur merresh me vende të ndryshme: “star-system”-i. Ka aktorë të famshëm kudo dhe të tjerë që njihen vetëm në vendin e tyre. Si veproni?

«Sërisht: vendosin ekipet tona lokale. Në Indi kam njohur Shah Rukh Khan, ndoshta një nga yjet më të mëdhenj në botë. Një ditë shkova në shtëpinë e tij. Kur arritëm te hyrja, ishin pesëqind vetë jashtë portës. Duartrokisnin sapo makina ndalej. E pyeta: “Është kështu çdo ditë?”. Ai u përgjigj: “Jo, ndonjëherë janë pesëmijë”. Një vit më pas, erdhi ai në Los Anxhelos. Shkuam në restorant dhe askush s’e njihje. Nga fundi i darkës, dy turiste indiane u ulën pranë, e njohën dhe nisën të bërtisnin. Ai shkoi të bënte një selfie me to».

Tani ju priteni me të gjitha nderimet në festivale, përveçse në Cannes.

«Në 2017 shkuam atje me dy filma, Okja dhe The Meyerowitz Stories, por pastaj ata ndryshuan rregulloren: filmat s’mund të ishin në garë nëse nuk dilnin në salla. Kështu, ne ndaluan së shkuari. Cannes është një institucion pak i mykur, por s’do ta detyroja kurrë askënd të ndryshojë rregullat që i ka vendosur vetes».

Pas pushtimit të Ukrainës, e tërhoqët Netflix-in nga Rusia. Sot vendet pa Netflix janë Rusia, Kina, Krimea, Koreja e Veriut dhe Siria. Ka gjasa që njëri prej këtyre apo tregje të tjerë të hapen?

«Qëllimi ynë është të përmirësojmë biznesin aty ku jemi tashmë. Mund të shpërdorojmë shumë energji duke u përpjekur të hyjmë në

kontekste ku s’ka interes».

Po politika e doganave e Trump-it? A mund të jetë problem për ju?

«E përqendrojmë forcën te ajo që mund të kontrollojmë. Por është thënë se edhe presidenti Trump e ka pranuar disa herë se ka një lloj përjashtimi kulturor ndaj disa politikave. Nëse seriali quhet Emily in Paris, duhet xhiruar në Paris, apo jo? Ne investojmë si në produksionet në SHBA, ashtu edhe jashtë, ku kontribuojmë dukshëm në ekonomitë lokale. Jemi një kompani globale argëtimi dhe përpigëmi të punojmë në harmoni me territoret».

Netflix ka mbi 300 milionë abonentë në botë. Por përballë kaq shumë ekraneve shtëpiake, si mund të mbijetojnë kinematë?

«Biznesi im është të argëtoj njerëzit kur janë në shtëpi. Por s’mendoj se kjo bie ndesh me kinemanë. Shikuesi mesatar sot sheh shtatë filma në muaj në Netflix; në kinema, ndoshta sheh një. Por raporti mes asaj që sheh në shtëpi dhe asaj që sheh në sallë është i gjallë. Ne kemi një model biznesi që garanton prodhim të vazhdueshëm filmash dhe shikim të pandërprerë të tyre. Po injektojmë “gjak të ri” në këtë sektor».

Të flasim për algoritmin ...

«Po ne s’fshehim asgjë! (qesh). Algoritmet shërbejnë për ta ngushtuar fushën drejt asaj që, me shumë gjasë, do të të pëlqejë. S’është gjithmonë i saktë në këtë kuptim, por ndonjëherë, kur ia qëllon, të paraqet diçka që mendon se s’do ta pëlqesh — dhe pastaj të pëlqen. Tani për tani, K-Pop Demon Hunters është ndoshta nisja më e mirë në historinë e Netflix-it: është filmi ynë më i parë në 91 ditët e para. Kolona zanore i ka katër këngë në Top 100 të Billboard-it. Filmi i fundit që ka pasur tre këngë në Top 100 ishte Saturday Night

Fever në 1978. A më intereson mua K-pop? Jo, por fëmijët e mi kthehen nga shkolla dhe më flasin për të; atëherë e provoj, ndoshta më pëlqen, muzika më pëlqen — dhe ndoshta bëhem fans edhe unë».

Po juve, zakonisht, çfarë ju propozon algoritmi?

«Unë s’jam shembull tipik (qesh)! Unë shoh gjithçka, ndaj më propozon gjithçka».

Në Francë keni lidhur një marrëveshje me rrjetin kombëtar TF1. Si funksionon?

«Do të përthithim përmbajtjet e TF1 dhe do t’i bëjmë të disponueshme për abonentët tanë. Shpresojmë të jetë model i riprodhueshëm edhe në vende të tjera. Unë e shoh thjesht si zgjerim të modelit tonë të licencimit».

Cilat janë zhanret nga TV-ja kombëtare që ju interesojnë?

«Më e lehtë të themi çfarë s’do të bëjmë: informim, telenovela dhe sport — me përjashtim të ndonjë ngjarjeje live, siç ishte ndeshja mes Jake Paul dhe Mike Tyson».

A mund ta transmetoni ndonjë ditë natën e Oscarëve?

«Po, mundemi».

Të gjithë — nga Apple te HBO e deri te studiot “e vjetra” — kanë platformat e tyre të streaming-ut. A ka rrezik mbingopjeje të tregut?

«Shpresoj që, pavarësisht sa abonime ka një shikues, Netflix të jetë gjithmonë i pari ku regjistrohet dhe i fundit prej të cilit çregjistrohet».

Ka seriale të të tjerëve që do të donit t’i kishit prodhuar ju?

«Sigurisht! Të gjitha sukseset e të tjerëve! Edhe pse shpesh, nga propozimi deri te transmetimi, projektet ndryshojnë rrënjësisht.

KURTHI I ARIUT: NË FRONTIN E LUFTËS HIBRIDE TË RUSISË KUNDËR EUROPËS

Shkeljet e fundit të hapësirës ajrore evropiane nga avionë luftarakë dhe dronë rusë kanë ngjallur frikën se Moska po teston gatishmërinë e mbrojtjes ajrore të NATO-s. Por në kufirin lindor të Estonisë, aty ku ndodhet qyteti Narva – me një popullsi 98% rusishtfolëse – zgjedhjet vendore dhe planet për ndërtimin e një baze të re ushtarake kanë krijuar një klimë pasigurie dhe frike. Ishte ndoshta e pashmangshme që një propozim për të ndërtuar një bazë ushtarake në periferi të Narvës, qyteti i tretë më i madh në Estoni dhe që ndodhet drejtpërdrejt në kufi me Rusinë, të bëhej temë e debatit televiziv mes kandidatëve për kryetar bashkie. Vetëm pak ditë më parë, tre avionë rusë MiG-31 kishin hyrë dhe kishin qëndruar në hapësirën ajrore të Estonisë mbi Gjirin e Finlandës për 12 minuta, duke e detyruar qeverinë e Talinit të kërkonte një konsultim të Nenit 4 të NATO-s, që parashikon reagim kur kërcënohet integriteti territorial apo pavarësia politike e një vendi anëtar.

Estonia e ngriti çështjen edhe në Këshillin e Sigurimit të OKB-së në Nju Jork, ku aleatët perëndimorë paralajmëruan pasojat e rënda për çdo shkelje të mëtejshme. Donald Trump sinjalizoi mbështetjen e tij për rrëzimin e avionëve rusë, nëse do të përsëritej incidenti. Klima e tensionuar gjeopolitike u përkeqësua më tej nga një seri dronësh të pidentifikuar që fluturuan mbi aeroportet daneze, duke detyruar edhe mbylljen e aeroportit më të madh të vendit, në Kopenhagë. Kjo pasoi incidente të ngjashme me dronë rusë në Poloni dhe Rumani. “Është vetëm fillimi i një lufte hibride kundër Europës,” deklaroi kryeministrja daneze Mette Frederiksen në një fjalim drejtuar kombit.

Një qytet në kufi të nervave

Dikush mund të mendonte se një bazë ushtarake në Narva, e ndarë nga Rusia vetëm nga një lumë 101 metra i gjerë, do të pritej me entuziazëm. Por realiteti është shumë më i ndërlikuar. Lumi përshkohet nga “Ura e Miqësisë”, mbi të cilën estonezët kanë vendosur pengesa betoni

antitanke dhe po ndërtojnë një portë të rëndë sigurie. Por Narva, që është më afër Shën Petërburgut se sa Talinit, është një vend me identitet të përzier. 98% e popullsisë flet rusisht dhe shumë prej tyre ndjekin kanalet televizive ruse, edhe pse janë të ndaluara në Estoni. Sipas Kremlinit, shkelja ajrore “nuk ka ndodhur kurrë”; “nazistët në Talin”, siç i quan propaganda ruse, janë ata që “bëjnë atë që bën partia globale e luftës”.

Të tjerë në Narva e kuptojnë se këto janë lajme të rreme, por prapë kanë frikë “të ngacmojnë ariun rus”. Shumë thonë se trupat estoneze janë të mirëpritura, por jo ushtarët e NATO-s. Kandidatët për kryetar bashkie në debat pranuan se baza është tashmë një vendim i marrë, por kritikuan mënyrën si u komunikua, duke e parë si burim frike, jo sigurie, për 53 mijë banorët e qytetit.

Një provë për NATO-n dhe për vetë Baltikun

Shkelja e hapësirës ajrore dhe përfshirja e dyshuar e Rusisë në sulmet me dronë janë një test për NATO-n – por edhe për kohezionin e vetë vendeve baltike, ku komunitetet rusishtfolëse janë të mëdha dhe shpesh të ndjeshme ndaj propagandës ruse. Në prag të zgjedhjeve vendore, situata në Estoni është “plot rrezik”, thotë Katri Raik, ish-ministre e Brendshme dhe aktualisht kryetare e bashkisë së Narvës. Ajo përshkruan qytetin si të varfër e të lënë pas dore, të goditur rëndë nga mbyllja e minierave të shistit bituminoz, dhe për dekada i harruar nga qeveria qendrore. “Për ne ishte në rregull, sepse ndiheshim si një ishull,” thotë ajo. “Por tani shteti është afruar shumë më pranë nesh.” Pas pushtimit rus të Ukrainës, qeveria estoneze urdhëroi heqjen e rreth 400 monumenteve sovjetike, të cilat sipas saj përkujtonin pushtimin, jo çlirimin e vendit.

Më e diskutueshme ishte heqja e një tanku sovjetik në hyrje të Narvës, që shkaktoi protesta të forta. Raik – një nga vetëm 2% e banorëve që kanë estonishten si gjuhë amtare – mori kërcënime me vdekje pasi u përpoq të



ndërmjetësonte mes qeverisë dhe qytetarëve. Përveç kësaj, mbyllja e Urës së Miqësisë për automjetet dhe mallrat – tani kalojnë vetëm këmbësorët – ka qenë një goditje ekonomike. Edhe pse rusët e mbyllën të parët, rregullat e reja të kontrollit nga pala estoneze kanë krijuar rradhë të gjata dhe pakënaqësi.

Gjuhë, fe dhe zgjedhje të ndaluara

Qeveria estoneze është akuzuar për “shtypje të lirisë fetare”, pasi ka nisur ndarjen e Kishës Ortodokse Ruse në Estoni nga Patriarkana e Moskës, që shihet si e lidhur ngushtë me Kremlinin. Një tjetër ligj parashikon që shkollat me gjuhë mësimi ruse të mbyllën deri në vitin 2030, duke detyruar mësimin vetëm në estonisht – çka ka shkaktuar pakënaqësi tek familjet që përdorin rusishten në shtëpi. Për më tepër, është ndaluar e drejta e votës për qytetarët që nuk janë të BE-së, përfshirë rusët dhe bjellorusët që jetojnë në Estoni. “Një e treta e njerëzve në Narva nuk do të mund të votojnë,” thotë Raik. “Kjo është një dhuratë për populistët.”

Kur kultura bëhet front lufte

Maria Smorzevskihh-Smirnova, drejtoresha e Muzeut të Narvës, është një tjetër figurë që u përfshi

në këtë spirale tensioni. Ajo u dënua në mungesë me 10 vjet burg në Rusi, pasi kishte vendosur në muret e kështjellës së muzeut një poster që e quante Vladimir Putinin kriminel lufte, duke e krahasuar me Hitlerin. Mesazhi i saj i drejtohej turmave që më 9 maj, në Ditën e Fitores (fitorja e Bashkimit Sovjetik mbi Gjermaninë naziste), festojnë në anën tjetër të lumit, në qytetin rus Ivangorod, ku shfaqen ekrane gjigante me imazhe të Putinit dhe filma lufte. “Është kulti i luftës dhe i vdekjes, një glorifikim i pushtimit të Ukrainës,” tha ajo. Pas aktit të saj, u përball me kërcënime me vdekje online: “Do të të vrasim, e dimë ku jeton, e dimë ku ecën.” Por ajo shtoi: “A do të heshtim përgjithmonë? Jo.”

Lufta e përditshme e kufirit

Shefi i policisë kufitare të Estonisë, Egert Belitsev, përshkruan Narvën si një zonë provokimesh të vazhdueshme: balona vëzhgimi që shfaqen papritur, refugjatë që shtyhen përtej urës nga rojet ruse, ndërhyrje GPS që pengojnë operacionet e shpëtimit. “E gjithë kjo bëhet për të parë si reagojmë, sa larg jemi gati të shkojmë, çfarë mund të bëjmë,” thotë ai. Çdo reagim i autoriteteve estoneze përshkruhet nga propaganda ruse si agresion militarist dhe sulm ndaj të drejtave të rusishtfolësve në Narva. Madje vetë Putini, në vitin 2022, kishte thënë se “do të ishte e

justifikueshme të merrej Narva për ta mbrojtur”. Ndaj frika se mund të shfaqen “njerëzit e vegjël të gjelbër” – ushtarë rusë pa uniformë zyrtare, si në Krime – nuk është më krejt imagjinare.

Përgjigjja e Talinit

Ministri i Brendshëm i Estonisë, Igor Taro, ish-gazetar, është përgjegjës për politikën ndaj zonës kufitare dhe viziton shpesh Narvën. Ai thotë se çdo vendim i qeverisë ka pasur arsyet e veta: Shkollat në rusisht thellonin ndarjen etnike. Monumentet sovjetike ishin simbole të pushtimit. Dhe votimi nga qytetarë të shtetit agresor nuk ishte më i pranueshëm apo i sigurt. Por ai pranon se rreziku është real. Javën e kaluar, një banor i Narvës u dënua për spiunazh për FSB-në ruse, që nga viti 2017. “Ishte një njeri i zakonshëm, shumë shoqëror, që mund të mblidhte informacione nga shumë njerëz,” tha Taro. Estonia ka nxjerrë mësim nga Ukraina, ku aktivistët pro-rusë në Donetsk dhe Luhansk përfunduan duke krijuar republikat separatiste. “Kjo është ajo që duam të shmangim,” thekson ai. “Ata po përgatisin terrenin – në fushën e informacionit dhe në të gjitha nivelet – por ne kemi masa për t’i ndaluar.” Dhe shton: “Ne jemi stërvitur për çdo skenar... edhe për këtë urë.” / **The Guardian – Bota.al**

Yellowstone (sot në Paramount+, me Kevin Costner) na ishte ofruar shumë vite më parë. Harvey Weinstein ishte producenti dhe Robert Redford do ta interpretonte».

Keni frikë konkurrencën e YouTube dhe TikTok? U marrin shikues, sidomos të rinjtë.

«Që nga fillimi kemi qenë në garë me gjithçka që i çon njerëzit para një ekrani. Por pikërisht kjo është puna jonë: duhet të jemi emocionues, duhet të fitojmë ato



momente me shikuesit. Për më tepër, ne i përdorim shumë TikTok-un dhe YouTube-in për të promovuar përmbajtjet tona. Dhe, për t’u kthyer te Demon Hunters: një fenomen i tillë ndez rrjetet sociale dhe kjo sjell ujë në mullirin tonë».

Sa i përket rivalëve: ju luani veten në The Studio, një seri satirike e Apple për botën e sotme të kinemasë. Si ndodhi?

«Seth Rogen, autor dhe protagonist, më telefonoi: “Kam një ide. Nëse të duket argëtuese, na bëhet qejfi të marrësh pjesë. Nëse jo, e heqim”. E lexova skenarin dhe më pëlqeu, prandaj shkova në set super i përgatitur, me batutat përmendësh e gjithçka. Pastaj një ditë hyra në barin e zakonshëm pranë shtëpisë, ku kaloj gjithnjë rrugës për në zyrë, dhe zonja që

më shërben kafenë thotë: “S’e dija që ishe aktor”. U përgjigja: “S’jam aktor”. Ajo: “Të pashë në TV. Luaje Ted Sarandos-in”. “Po unë jam Ted Sarandos!”».


Ju, në fakt, keni sajuar një profesion dhe një biznes që s’ekzistonte. Kur ishit i ri, ç’dëshironit të bënit kur të rriteshit?

«Shikoja serialin Lou Grant, të vendosur në një redaksi, dhe ëndërroja të bëhesha gazetar — madje gazetar investigativ si heroi im, Don Bolles. Ishte një reporter që,

kur unë isha ende fëmijë, po bënte një reportazh për mafien në Arizona dhe u vra me bombë në makinën e tij. Ngjarja më tronditi shumë; mendoja: mjaftonte të mos e shkruante artikullin dhe s’do të vritej. Kërkimi i së vërtetës për të ishte aq i rëndësishëm sa dha jetën për të».

A ka bërë kush një film për këtë gazetar heroik?

«Jo. Dhe s’e di pse. Mendoj se do të ishte një film i madh. Duhet ta prodhoj unë». / **Il Venerdi – Bota.al**



INFANTINO: FFK-JA DHE ADEMI PO BËJNË PUNË TË SHKËLQYESHME, SHTETI T'I PËRKRAHË

Prishtinë, 16 tetor - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, javën e kaluar ka vizituar Kosovën për të marrë Medaljen Presidenciale të Meritave nga presidentja Vjosa Osmani, një nder ky për kontributin e tij ndaj futbollit kosovar. Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, ai ka dhënë një intervistë për "FFK Podcast", ku ka folur për rrugëtimin e Kosovës drejt anëtarësimit në UEFA dhe FIFA, për zhvillimin e futbollit në vend dhe për punën e FFK-së dhe presidentit Agim Ademi. Në këtë intervistë, Infantino ka shprehur emocionet e tij lidhur me nderimin që ka marrë, ndikimin e futbollit në ndërtimin e identitetit të Kosovës, dhe rëndësinë e investimeve të rinjve dhe në infrastrukturë për zhvillimin e futbollit në vend.

I nderuar z. president, është një privilegj dhe nder i vërtetë për mua t'ju mirëpres në këtë intervistë në emër të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe në emër të gjithë familjes së futbollit në vendin tonë, e cila do të jetë përgjithmonë mirënjohëse dhe falënderuese ndaj jush për mbështetjen e pakushtëzuar gjatë rrugëtimit tonë në FIFA dhe para anëtarësimit tonë në UEFA dhe FIFA. Mirë se u ktheve!

Infantino: Si ndjesi, është fantastike të jem sërish këtu në Kosovë. Është e mrekullueshme të marrësh këtë nderim, Medaljen Presidenciale të Meritës nga presidentja Osmani, si president i FIFA-s. Sigurisht, ndihem jashtëzakonisht i nderuar për këtë çmim. Personalisht ndjej shumë emocione, sepse kam kaluar nëpër gjithë historinë e Kosovës dhe procesin e anëtarësimit të saj në UEFA dhe gjithashtu në FIFA. Në Kongresin tim të parë si president i FIFA-s, Kosova u pranua në familjen e FIFA-s, dhe pata nderin të isha president i FIFA-s në atë kohë. Ishte nëntë vjet më parë. Kështu që vitin e ardhshëm do të kemi edhe diçka më shumë për të festuar, dhjetëvjetorin e pranimit në FIFA.

Në një nivel të ri...

Infantino: Saktësisht. Absolutisht. Një nder i madh, vërtet një nder i jashtëzakonshëm dhe një emocion i madh.



Ashtu siç thatë, është hera e dytë që vini këtu brenda një periudhe të shkurtër. Si ndiheni dhe cilat janë përshtypjet tuaja për Kosovën si shtet, por veçanërisht në aspektin e futbollit, për zhvillimin e Federatës dhe të futbollit në përgjithësi në Kosovë?

Infantino: Më lejoni të them, para së gjithash, se sigurisht kjo medalje, ky çmim, i dedikohet Fadil Vokrri. E kam takuar shumë herë dhe nëse Kosova është ajo që është sot, si në aspektin e jetës futbolistike, ashtu edhe si shtet, ai padyshim meriton shumë lëvdata. Ai përfaqëson qëndrueshmërinë dhe forcën e popullit të Kosovës. Dhe, e dini, për mua ka qenë një privilegj i madh ta njoh atë. Dhe nëse shohim se si është zhvilluar futboli në Kosovë gjatë dhjetë viteve të fundit, që nga anëtarësimi në UEFA dhe FIFA, është vërtet diçka e jashtëzakonshme. Dua të them, investimet që janë bërë nga Federata për futbollin e vajzave, për futbollin e meshkujve, për ekipet kombëtare janë mbresëlënëse. Sot, askush nuk dëshiron të vijë të luajë kundër Kosovës, sepse të gjithë kanë frikë se do të humbasin. Dua të them se ekipi është i fortë dhe ju keni qasur shumë tifozë në Kosovë dhe gjithandë. Këto janë shembuj për të rinjtë e një vendi të ri, i cili ka nevojë të ndërtojë gjithashtu identitetin e vet si shtet. Dhe futboli, padyshim, kontribuon shumë në këtë drejtim. Sigurisht, mund të shohim edhe renditjen e ekipit kombëtar dhe gjithashtu rezultatet që janë arritur. Mund të shohim ekipet e të rinjve dhe pasionin që vazhdon të rritet. Mund të shohim gjithashtu edhe ligën vendore. Po ashtu, mund të

shohim të gjithë lojtarët nga Kosova, ndoshta të brezit të dytë. Disa prej tyre janë të brezit të tretë, disa të tjerë janë të brezit të dytë. Saktësisht. Të gjithë e duan vendin e tyre dhe duan të kthehen për të luajtur për kombëtaren e tyre. Mendoj se kjo tregon se puna që po bëhet këtu është e shkëlqyer.

Jemi të vetëdijshëm që është hera e dytë që vini këtu, por për një kohë shumë të shkurtër, dhe ndoshta nuk keni pasur mundësinë të shihni shumë. Megjithatë, me siguri keni marrë informacione nga njerëzit përreth jush për ndikimin që kanë pasur programet e FIFA-s në zhvillimin që përmendët. Cilat janë mendimet tuaja në përgjithësi për zhvillimin që po bën futboli ynë dhe për rrugëtimin që po ndjek?

Infantino: Mendoj se ndikimi që FIFA dhe UEFA ka pasur, ka qenë shumë i madh. Por duhet të them gjithashtu se ne i japim çdo vendi të njëjtat fonde mbështetëse dhe pastaj, gjithçka varet nga ajo që vendi bën me to dhe si i përdor ato mundësi. Dhe në Kosovë, këtu me mikun tim Agim Ademi, puna që është bërë është absolutisht e shkëlqyer. Këtë e shohim te gjyqtarët, e shohim te zhvillimi i të rinjve, te ekipet kombëtare të të rinjve. Talenti që keni nuk do të dalë në pah nëse nuk punojmë për ta, nëse nuk e kultivojmë atë. Dhe puna që është bërë është vërtet e jashtëzakonshme, sepse, sigurisht, bëhet fjalë për një vend të ri. Është një vend që ende po ndërtohet, apo jo? Prandaj, kontributi i futbollit në vetë shtetin mendoj se është shumë i rëndësishëm. Dhe ajo që është bërë nga Federata, mund vetëm

t'i përgëzoj dhe t'i uroj për gjithë punën që kanë bërë deri tani. Mendoj se faza e ardhshme, nëse mund ta them kështu, duhet të jetë në bashkëpunim me UEFA dhe FIFA, me qeverinë, për të investuar më shumë në infrastrukturë. Dhe ky është pikërisht qëllimi ynë thelbësor, 100 për qind. Kjo është ajo që na duhet për të arritur nivelin më të lartë, më të lartë në Evropë gjithashtu. Dhe sigurisht na duhet edhe mbështetja juaj për të shtyrë pak më tej përmes institucioneve këtu.

Si mendoni? T'i përdorni lidhjet tuaja me presidenten e shtetit tonë?

Infantino: Më besoni, unë po e bëj këtë. Do ta bëj. E thashë edhe në fjalimin tim më herët. Duhet të besoni te të rinjtë. Duhet të investoni si shtet. Kjo është një investim në një ëndërr, në një mundësi dhe në një shpresë për fëmijët. Jo që çdo fëmijë të bëhet futbollist profesionist, ky nuk është qëllimi, por qëllimi është t'i edukojmë, t'u japim mundësi dhe shanse. Futboli është shumë i rëndësishëm për shumë arsye, jo vetëm si lojë, por edhe për të edukuar fëmijët. Për këtë na nevojitet infrastrukturë, na duhet ta ndiejmë, na duhen stadione. Na duhet një vizion/projektion për të ardhmen, që jam i sigurt se edhe qeveria do ta marrë parasysh dhe do të bashkohen në këtë vizion.

Ju e përmendët më herët edhe bashkëpunimin që keni me presidentin e Federatës së Futbollit të Kosovës, z. Agim Ademi, i cili së fundmi është emëruar gjithashtu anëtar në Komitetin e Marrëdhënieve

Institucionale të FIFA-s. Si e vlerësoni bashkëpunimin që keni me të personalisht dhe projektet që janë duke u zhvilluar në fushën e futbollit të drejtuar nga ai?

Infantino: Po, unë kam një marrëdhënie shumë të mirë me Agim Ademin, sigurisht. E përgëzoj për emërimin e tij për herë të parë si anëtar i Komitetit të Marrëdhënieve Institucionale të FIFA-s. E njoh prej shumë vitesh dhe e di mirë se çfarë po bën për futbollin. Ai po bën shumë, në një mjedis që nuk është gjithmonë i lehtë. Le ta pranojmë. Por ai e ka zemrën në vendin e duhur, vërtet. Ai e bën punën e tij bashkë me ekipin me shumë pasion. Ai di t'i prejë ndjenjat e dhura, emocionet e dhura dhe shpirtin e shumë lojtarëve. Fola me të edhe më herët sot për këtë dukuri.

Për shumë lojtarë nga Kosova që kanë lindur dhe janë rritur jashtë vendit, sigurisht që ka pasur shumë ndikime dhe histori të ndryshme. Siç e dini, shumë prej tyre në kohën kur Kosova ende nuk ishte e pranuar ndërkombëtarisht, luanin për ekipin kombëtar të Zvicrës, për shembull si Xherdan Shaqiri dhe të tjerë. Ata ishin ndër lojtarët më të mirë që mund të kishin luajtur ndonjëherë për Kosovën, por në atë kohë Kosova nuk ishte e pranuar ndërkombëtarisht. Por e dini, të gjithë këta lojtarë ndiejnë shumë për Kosovën, sepse prindërit e tyre kanë qenë të detyruar të largohen dhe të integrohen në një vend tjetër. Megjithatë, ata janë rritur me rrënjët e vendit të tyre. Dhe, e dini, Agimi, Federata, ekipi kombëtar e kuptojnë këtë dhe dinë t'i prekin ato ndjenja. Mendoj se kjo është shumë e rëndësishme, sepse identiteti i vendit është diçka thelbësore. E dini, jemi miq me të gjithë, por duhet ta ndiejmë se zemra rreh për vendin dhe për popullin e Kosovës. Është pikërisht kjo ndjenjë krenarie që do t'ju sfidoja ta mbani gjallë.

Z. president, edhe një herë, ishte një privilegj dhe nder i madh për mua t'ju mirëpres në këtë intervistë dhe t'ju falënderoj për gjithçka që keni bërë për vendin tonë dhe për futbollin tonë.

Infantino: Faleminderit. Faleminderit shumë. Faleminderit sërish për nderin që ma keni bërë.

Interi del nga kriza financiare me bilanc pozitiv dhe të ardhura historike

MILANO, 16 TETOR - Interi ka njoftuar se klubi ka përfunduar vitin me një fitim prej 35.4 milionë eurosh, diçka që nuk ishte arritur “në historinë moderne” të klubit, përfshirë një të ardhur rekord prej 567 milionë eurosh. “Nerazzurrët” kanë qenë duke transformuar situatën e tyre financiare që

nga rënia në krizë gjatë mbylljes për shkak të COVID-it në vitin 2020, e cila u shtua mbi borxhe të mëdha ekzistuese. Pika e kthesës ishte pa dyshim mospagimi i huas nga “Suning”, që çoi në marrjen efektive të klubit nga fondi amerikan “Oaktree” në maj të vitit 2024. Që prej asaj kohe, dhe me Beppe

Marottën të vendosur si president, klubi ka ulur shpenzimet dhe ka rritur të ardhurat, ndihmuar edhe nga arritja në dy finale të Ligës së Kampionëve në tri vite, si dhe pjesëmarrja në Kupën e Botës për Klube. E gjithë kjo ka bërë që Interi të regjistrojë një fitim prej 35.4 milionë eurosh në vitin fiskal 2024/2025, një rritje

neto prej 70 milionë eurosh nga qershori 2024, kur klubi operonte me një humbje prej 35.7 milionë eurosh. Të ardhurat e tyre gjithashtu kanë arritur një rekord të ri prej 567 milionë eurosh, një rritje prej 94 milionë eurosh krahasuar me sezonin e kaluar. Ata, gjithashtu, kanë përmirësuar stabilitetin financiar duke shlyer



obligacionet më herët dhe duke siguruar një hua afatgjatë prej 350 milionë eurosh.

FODA: PO ZHVILLOHEN BISEDIMET PËR KONTRATËN E RE, MUND TË QËNDROJ MË GJATË TE KOSOVA

PRISHTINË, 16 TETOR - Pas një fushate jashtëzakonisht të suksesshme në kualifikimet për Kupën e Botës, Kosova vazhdon t'i mbajë gjallë shpresat për pjesëmarrje në turneun e madh të vitit të ardhshëm.

Trajneri Franco Foda ka zbuluar se dëshiron ta vazhdojë bashkëpunimin me “Dardanët”, duke lënë të kuptohet se një rinovim kontrate është në shqyrtim.

“Po, është e vërtetë që po zhvillohen bisedime. Si federata ashtu edhe trajneri duhet të jenë të kënaqur – me ambientin, me profesionalizmin. Prandaj është plotësisht e mundur që të qëndroj në Kosovë edhe për një periudhë më të gjatë”, ka thënë Foda për mediat gjermane,

përcjellë “4-4-2”.

Ish-trajneri i FC Zurich është shprehur shumë i kënaqur me punën në Federatën e Futbollit të Kosovës dhe marrëdhënien që ka ndërtuar me skuadrën. Aktualisht, kontrata e 59-vjeçarit gjerman është e vlefshme deri në fund të korrikut 2026.

Së fundmi, Kosova ka regjistruar një fitore të madhe në udhëtim ndaj Suedisë, një rezultat që ka rikthyer besimin dhe optimizmin në kampin “dardan”. Nëse gjithçka shkon sipas planit në ndeshjet e nëntorit, Kosova mund ta sigurojë kualifikimin direkt për Kupën e Botës, përndryshe rruga drejt Botërorit do të vazhdojë në “play-off” gjatë muajit mars të vitit të ardhshëm.



ARDIAN ISMAJLI RIKTHEHET NË STËRVITJE ME TORINON



TORINO, 16 TETOR - Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Arrian Ismajli, është rikthyer në stërvitje me skuadrën e tij, Torinon, pas një mungese nga një dëmtim muskular. 29-vjeçari ka pasur probleme fizike gjatë muajit shtator dhe për pasojë mungoi në grumbullimin e fundit të Kombëtares shqiptare për dy sfidat e rëndësishme kualifikuese të muajit tetor. Mbajtësi shqiptar ka lënë pas

dëmtimin dhe tashmë është rikthyer në seancat stërvitore me grupin, duke vijuar përgatitjet.

Pavarësisht se është rikuperuar, trajneri i Torinos pritet ta ketë në dispozicion Ismajlin vetëm për ta aktivizuar nga stoli në ndeshjen e fundjavës.

Torino do të përballet të shtunën me Napolin, në një ndeshje të vështirë të kampionatit italian, Seria A, ku

objektivi i skuadrës është të grumbullojë pikë dhe të ngjitet në tabelë. Megjithatë gjasat janë të vogla që Ismajli të jetë titullar, prania e tij në stol është një lajm i mirë për klubin dhe për Kombëtaren shqiptare që po përgatitet për ndeshjet vendimtare të muajit nëntor. Që prej transferimit të tij te Torino, Arrian Ismajli ka regjistruar tri paraqitje me fanellën e klubit italian.

PSG-ja ofron Fabian Ruiz në këmbim të yllit të Real Madridit

PARIS, 16 TETOR - Debati rreth Endrick ka arritur një intensitet të papritur, pavarësisht se tregu i transferimeve është i mbyllur. Sulmuesi i ri brazilian i Real Madridit, i cili ende nuk ka debutuar këtë sezon, po tregon shenja padurimi, ndërkohë që Paris Saint-Germain po ndjek me kujdes çdo lëvizje të tij. Fillimi i sezonit nuk ka qenë i lehtë për Endrick. Pas rikuperimit nga një dëmtim muskular, ai është grumbulluar disa herë, por

Xabi Alonso nuk i ka dhënë ende minuta.

Mungesa e hapësirës po kthehet në shqetësim, veçanërisht në një vit kur shumë lojtarë po përpiqen të sigurojnë vend në Kupën e Botës 2026.

Sipas “Defensa Central”, drejtuesit sportivë të Real Madridit këmbëngulin se braziliani nuk është në shitje dhe çdo përpjekje nga PSG për ta transferuar do të ishte e pamundur. Klubi spanjoll nuk sheh arsye për të nxituar me

zhvillimin e tij, pasi plani është ta integrojë gradualisht në sistemin e Xabi Alonso. Interesimi i Paris Saint-Germain është i vërtetë dhe vjen si kërkesë direkte nga trajneri Luis Enrique, i cili e sheh Endrick si përforsimin ideal për të rinovuar repartin ofensiv. Por pengesa kryesore është e qartë: marrëdhëniet mes dy klubeve janë të ngrira që nga çështja Mbappe, duke e bërë pothuajse të pamundur një negociatë tradicionale. Për këtë arsye, PSG-ja ka filluar të

shqyrtojë një alternativë tjetër: këmbim lojtarësh. Megjithatë Real Madrid nuk pritet të pranojë, parisienët do të ishin të gatshëm të ofronin një lojtar nga skuadra e tyre, përveç dy mesfushorëve kyç, Vitinha dhe Joao Neves. Opsioni më i besueshëm do të ishte Fabian Ruiz, një lojtar që më parë ishte në radarët e Real Madridit gjatë kohës së Carlo Ancelottit dhe që gjithashtu mund të interesojë Xabi Alonso për shkak të versatilitetit dhe teknikës së



tij. Megjithatë, në Valdebebas nuk e konsiderojnë largimin e Endrick, sidomos jo në një shkëmbim që nuk sjell përfitime të menjëhershme sportive.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 5 dhe 7 i Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e i/c Teknologjisë Informative (1) pozitë
I raporton: Udhëheqësit të Zyrës për Administratë dhe Financa
Niveli i pagës: 8.08
Orët e Punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar
Vendi Punës: “Instituti A” QKUK, 10 000 Prishtinë

Detyrat e përgjithshme:

- Mbikëqyr, mirëmban dhe intervenon në sistemin e teknologjisë informative në pajisjet përkatëse të zyrës;
- Kujdeset për funksionimin, sigurinë dhe funksionalitetin e rrjetit të brendshëm të OMK-së;
- Siguron funksionalitetin e paisjeve të teknologjisë informative për nevojat e zyrave të OMK-së;
- Mirëmbajtjen, azhurnimin dhe zhvillimin e ueb faqes zyrtare të OMK-së;
- Përpunon, mirëmbanë dhe zhvillon bazën e të dhënave të regjistrave të anëtarëve të OMK-së;
- Ofron shërbime profesionale për nevojat e ndryshme të OMK-së lidhur me aktivitetin dhe veprimtarinë përkatëse;
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e përgjegjësisë.

Kualifikimet:

- Të jetë i diplomuar në ndonjë nga drejtimet e shkencave kompjuterike apo të ketë kryer trajnime adekuate të çertifikuara;
- 1 (një) vit përvojë pune në fushën e teknologjisë informative;

Aftësitë:

- Njohja e programeve për dizajn do të konsiderohet përparësi;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Të jetë fleksibil/e dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- I/e aftë të mbajë informatat konfidenciale në mënyrë të përshtatshme;
- Personalitet të përkushtuar, me iniciativë, aftësi dhe vullnet për të marrë përgjegjësi;
- Shumë i/e mirë në punë ekipore dhe aftësi për të mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Njohja e gjuhës angleze e obligueshme;

Mënyra e aplikimit;

Aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike në adresën: info@omk-rks.org

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i OMK-së [Formulari i aplikimit](#)
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetë së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Letër rekomandimet.
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Konkursi publik është i hapur deri më 31.10.2025;
- Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
- Faza e testit me shkrim 10 ditë pas fazës së verifikimit;
- Faza e intervistës deri në 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim;
- Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Shënim: Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit;

- Vlerësimi i kandidatëve zhvillohet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistimit (testim me gojë);
- Testi me shkrim - maksimumi 70 pikë;
- Intervista - maksimumi 20 pikë
- Jetëshkrimi - maksimumi 10 pikë.

Oda e Mjekëve të Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.

Shpallja është e hapur që nga data 16.10.2025 deri më 31.10.2025 në ora 23:59.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel.: 049/872-300 apo 038/544-872.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA



**Kuvendi Komunal
Malishevë
Drejtoria Komunale e
Arsimit**

**Gjimnazi “Hamdi Berisha”
Malishevë**



Nr prot.:114/25

Datë:17.10.2025

Mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për aktivitetet jashtë shkollore, Gjimnazi “Hamdi Berisha” në Malishevë shpallë:

OFERTË PËR EKSKURSION

Gjimnazi “Hamdi Berisha” në Malishevë shpall ftesë për ofertë për zgjedhjen e agjencionit të udhëtimit për organizimin e Ekskursionit në Republikën e Shqipërisë me maturantë për vitin shkollor 2025/2026.

Kohëzgjatja e ekskursionit do të jetë 4 bujtje/ 5 ditë, me pansion të plotë.
Në ekskursion do të marrin pjesë 300 nxënës.

Agjencioni duhet të plotësojë këto parakushte:

1. Agjencioni duhet të jetë i licencuar,
2. Të ketë bërë kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore
3. Të ketë numer të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve, do të merret parasysh edhe viti i prodhimit të autobusëve,
4. Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendorë të ngasësve të autobusëve.
5. Agjencioni duhet të siguroj përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmitë (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit.
6. Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencen) e akreditimit të ushqimeve në Shqipëri të vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit
7. Kategorizimi do të bëhet në bazë të kriterëve dhe sigurisë për nxënësit, ku edhe do të vendoset për ofertën dhe vendin se ku do të vendosen nxënësit (hotelin) nga komisioni përkatës ditën e hapjes së ofertës.
8. Agjencioni duhet të prezantoj menyn ditore për secilen ditë të qëndrimit në Shqipëri të vërtetuar dhe nënshkruar nga pronari i hotelit
9. Kontrata në mes agjencionit dhe hotelit
- 10 .Një konfirmim të rezervimit të hotelit përkatës të vërtetuar mes kompanis dhe hotelit me datë të caktuar.
- 11 .Licenca e ballos (Vallëzimit) ku nxënësit do të argëtohen e vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit.
- 12 .Hoteli ku bëhet akomodimi i nxënësve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik profesional.
13. Vërtetimi i ATK-së
14. Agjencioni duhet të ofroj listen e shoferëve dhe puntorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
15. Agjencioni duhet të mbulojë shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumentet historike.

Ofertat të cilat nuk i përmbushin kriteret e kërkuara nuk do të merren në shqyrtim.
Afati i aplikimit është 7 ditë nga dita e shpalljes më 17.10.2025 (ditën e premte)
Ofertat pranohen në sportelin e DKA-së në Malishevë.
Hapja e ofertave do të bëhet në ditën e fundit të aplikimit 24.10.2025 duke filluar nga ora 14:00, në shkollë.

Malishevë
17.10.2025
Gjimnazi “Hamdi Berisha” Malishevë

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin N.P.T “Trimi Metal” Sh.p.k. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Depo për grumbullimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave, rr. “Besim Shala” pn. Prizren, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t’u pajisur me Leje Mjedisore
Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 07.11.2025, në ora: 10:30, në hapësirat e Zyra e Administrates në objekti e ri te Kuvendit Komunal të Prizrenit, do të organizohet debat publik nga operatori N.P.T “Trimi Metal” Sh.p.k. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/5812/MMPHI/463/DMM, për veprimtarinë: Depo për grumbullimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave, rr. “Besim Shala” pn. Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
Linku për zoom:
<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vcxkxadVorQT09>
Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

N.P.T “Trimi Metal” Sh.p.k.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Irfan Hodaj shpall te pa vlefshme dëftesën e shkollës fillore “Luigj Gurakuqi” në Nashec.

- Blerim Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Profesionale Teknike “Gani Qfderbasha” Prizren.

- Samile Mullaibrahimi shpall të pavlefshme diplomën e sh.m të mjekësisë “Hysni Zajmi”.

- Muharrem Shala shpall të pavlefshme diplomën si dhe dëftesat e shkollës fillore “Mustafa Bakija”.

- Albatros Manxhuka shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Gjon Nikoll Kazazi”.

- Shqiprim Morina shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “12 Maji”.

- “Fire Protection Agency Rifel Action” LLC. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.

- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministraskvo Pravde - Ministry of Justice

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar
 Agencija za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom
 Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets



Ftesë për Ankand Publik

Datë 17.10.2025

Referenca: AAPSK – 014/2025

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi fillestar	Çmimi nga ofertuesi
1	Vilë model 'A' P+1	52.81 m ²	7,842.30€	
2	Vilë model 'Charm' P+1	78.53 m ²	11,661.70€	
3	Vilë model 'El Profesor' P+NK	100.48 m ²	14,921.30€	
4	Vilë model 'Zyre' P+0	18.46 m ²	2,741.30€	
5	Vilë model 'Zyre' P+0	42.2 m ²	6.266.70€	
6	Vilë model 'Zyre' P+0	18.46 m ²	2,741.30€	
7	Objekt (depo) P+0	85.1 m ²	0.00€	
8	Vilë model 'Berlin Deluxe' P+1	101.67 m ²	15,097.00€	
9	Vilë model 'Golden' P+NK	37.63 m ²	5.588.10€	
10	Objekt- Kiosk- Caffè&food P+0	18.28 m ²	2,714.60€	
11	Objekt- Kiosk- Caffè&food P+0	18.28 m ²	2,714.60€	

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri me **23.10.2025** në ora **11:00** në Zonën Kadastrale, Çagllavciçë, -në adresë: IT Group Shpk Maxhistrala Prishtinë- Ferizaj- KK Graçanicë. Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: **23.10.2025**, prej orës **10:00-11:00** në Zonën Kadastrale, Çagllavciçë, -në adresë: IT Group Shpk Maxhistrala Prishtinë- Ferizaj- KK Graçanicë.

Pasuritë e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>.

Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 12:00.Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA 1992

